




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e tetë (VIII) të Kuvendit të Komunës së Gjiilanit, më datë 27.6.2014. me këtë:

REND TË PUNËS

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1 Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Gjiilanit 2015-2017
 - 2.2 Propozim vendimi për emërimin e Komisionit për plotësimin e emërtimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Gjiilanit
 - 2.3 Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP "Ecohigjiena" në Gjiilan
 - 2.4 Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen për transportin e udhëtarëve "Kosovatrans" në Gjiilan
- 3 Propozim vendimi për lejimin e transferit të mjeteve financiare nga planifikimi i të hyrave vetanake
- 4 Propozim vendimi për lejimin e transferit të mjeteve financiare në shëndetësi
- 5 Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.15

Në punimet e seancës së tetë morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri
Zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesi i të Drejtave të Njeriut, z. Fazli Abdullahu
Përfaqësuesi i OSB-së, Basri Sejdiu
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, Shaban Terziu
Mediet

Seancën e tetë të Kuvendit të Komunës e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesja e Kuvendit zonja Valentinë Bunjkau – Rexhepi e cila fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, zv/kryetarin dhe të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët e monitorojnë punën e seancës së Kuvendit dhe mediet. Së pari kërkoj nga sekretari që ta verifikojë prezencën e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë?

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së tetë ishin prezent 31 anëtarë, kurse mungojnë 4 anëtarë: Imet Rrahmani dhe Rina Ahmeti mungojnë me leje, gjithashtu edhe Arben Maliqi i cili ka pasur rast të vdekjes dhe Jashar Jashari.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- sa i përket rendit të punës po iu njoftoj se pika tre dhe katër ka hyrë në rend të punës për pa kaluar në KPF, por kjo është bërë në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse, sepse është e nevojshme dhe obligim që të bëhet transfer i këtyre mjeteve. Ju lutem që të keni mirëkuptim për këto dy pikë të rendit të punës, por nëse ka ndonjë vërejtje në rend të punës mund ta merrni fjalën.

Fehmi Sylejmnai – së pari të gjithë besimtarëve mysliman ia uroj muajin e Ramazanit, duke i uruar agjërim sa më të lehtë!

Unë nuk mund të pajtohem me këtë konstatimin e kryesuese, sepse çdo pikë e rendit të punës e cila nuk debatohet dhe rekomandohet në KPF, konsiderohet jo ligjore. Vërejtja tjetër e imja është për pikë, 2.2., 2.3 dhe 2.4, sepse është bërë si dukuri që materiali po na silltet pa emra e që për mua është një shkelje ligjore. Në Kuvend anëtarët e komisionit duhet të sillen me emra. Kjo dukuri në vazhdimësi po na ndodhë dhe asnjë komision pa emra, unë dhe grupi i im nuk e pranojmë!

Sahit Abazi – edhe ne nuk pajtohem që të futet në rend të punës pika 3 dhe 4 për shkak, se në KPF nuk u pranua nga drejtuesit e LDK-së një propozim i yni i cili ishte pikërisht i kësaj natyre. Mandej vërejtje tjetër është se kryetari i Komunës e ka thënë se nga seanca e ardhshme do të ketë pyetje parlamentare e cila ka qenë desh të jetë pika e parë e rendit të punës, por e cila nuk është propozuar sot. Mandej një pikë tjetër e rendit të punës duhet të jetë edhe një pikë në të cilin do të debatohet për çështjen e punësimeve në Komunë, për të cilin temë kërkojmë që të diskutojmë nën të ndryshme, sepse i kemi vërejtjet tona dhe kërkojmë debat për këtë çështje.

Mevlyde Zejnullahu – në seancën e kaluar kemi filluar debatin për çështjen e arsimit, mirëpo edhe nga drejtori i Arsimit dhe të tjerët është thënë se çështje e arsimit duhet të debatohet në një pikë të veçantë dhe në një seancë të veçantë. Unë punoj në një shkollë

profesionale dhe kam obligim për t' i paraqitur shqetësimet e punëtorëve të arsimit, prandaj është mirë dhe tepër e nevojshme që të jetë një pikë e veçantë për arsimin në përgjegjësi.

Leonorë Bunjku- duke i pasur parasysh problemet dhe zhvillimet e fundit të cilat janë duke ndodhur në arsim, është premtuar se do të mbahet një seancë e veçantë. Mirëpo ajo seancë e veçantë nuk është mbajtur, por as sot nuk është paraparë si pikë e veçantë e rendit të punës. Unë mendoj se në të gjitha shkollat së shpejti fillon ndarja e orëve mësimore dhe procedurave të tjera, prandaj kjo seancë duhet të mbahet para shtatorit.

Mandej ka edhe disa problematika të tjera të cilat i kemi shqyrtuar edhe në Komitetin e Arsimit, e që është ngritja profesionale, përvoja e punës, diplomat, nota mesatare, licencimin, performancën etje. Kur është fjala te përvoja e punës nuk e kemi të qartë nëse kjo përvojë është marrë si bazë në të gjitha shkollat (a është e përfshirë në të gjitha shkollat përvoja e përgjithshme në arsim)? A ka ndonjë peshë nëse një mësimdhënës nuk e ka përvojën e punës brenda një institucioni të njëjtë? Kjo është absurde, sepse përvoja e punës bëhet brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe kjo përvojë duhet të njihet kudo që është punuar!

Bujar Nevzadi- së pari dy këshilltareve tona iu uroj suksese të cilat janë zgjedhur deputete të Kuvendit të Kosovës, zonjë Labinotë Demi, dhe Besë Baftiut dhe besoj se do të na përfaqësojnë dinjitetshëm në Kuvendin e Kosovës.

Në seancën e kaluar, unë e kam kërkuar listën e të punësuarve në Komunë dhe kjo çështje të futet në rend të punës, por mua më është sjell një listë me 6 zyrtarë të punësuar. Tërë kohën, kryetari i Komunës, drejtori i Arsimit po thonë se ne po punojmë sipas ligjit, por tash nuk na e keni sjell listën e të punësuarve në Komunë! Cila është arsyeja e fshehjes së kësaj liste? Është hera e tretë që po e kërkoj listën e të punësuarve në Komunë pas marrjes së qeverisjes nga ana e jua. Nuk e kam që qartë pse po e fshihni ?

Gjithashtu edhe listën e projekteve e kam kërkuar, por më është sjell nga Zyra e Prokurimit një listë me punët të cilat janë kryer në mandatin tonë. Unë e kam kërkuar listën e projekteve të realizuara në vitin 2014. I kam edhe disa pyetje të tjera, por është premtuar se do të jetë një pikë e veçantë; pyetje parlamentare dhe kur të hyjë në rend pune ajo pikë, unë do ta marrë fjalën.

Valentina Bunjaku- Rexhepi – listat të cilat janë kërkuar ne i kemi dorëzuar në adresa elektronike dhe nuk e di se për cilat lista është fjala?

Besë Baftiu – unë si vërejtje e kam pikën e parë e cila është propozuar në seancën e kaluar e cila do të jetë si pikë e parë e rendit të punës; pyetje parlamentare. Nëse futet kjo në rend të punës, atëherë unë do të bëj pyetje për drejtoren e Drejtorisë për Shëndetësi.

Për drejtoren për Shëndetësi e kam një pyetje lidhur me rekomandimet të cilat kanë dal nga mbledhja e Komitetit të Shëndetësisë e cila është mbajtur më 26.3.2014 për të cilat rekomandime drejtorja është zotuar se ato rekomandime shumë shpejtë do të realizohen.

Së pari është thënë se së shpejti do të ketë punëtorë teknik të shëndetësisë në ambulancën e fshatit Shurdhan, por edhe pse kanë kaluar tre muaj nga ajo datë ambulanca e fshatit Shurdhan është e mbyllur, sepse mungon tekniku medicinal.. Mirëpo edhe në disa fshatra të tjera nuk është gjendja më e mirë si p, sh. në fshatin Llashticë, banorët kanë ankesa të shumta, sepse mjeku nuk është i rregullt, por edhe kur shkon në vizita punon vetëm dy-tri orë. Rekomandimi tjetër i këtij komiteti ka qenë përkitazi me menaxhmentin e QKMF-së dhe marrjen e masave në këtë drejtim. Kjo është luftuar, në atë rast ku bëhet garë për pozita dhe punët kryhen shumë shpejtë, kurse aty ku duhet të punohet për të mirën e qytetarëve punët ngecin dhe

harrojmë që jemi në shërbim të tyre. Kërkoj nga drejtorja që të më jep sqarime pse nuk ka ndodhur ky punësim për cilin ka premtuar se do ta bëjë shumë shpejtë?

Avdyl Aliu- në emër të grupit të LDK-së i përgëzoj koleget tona të cilat arritën të zgjedhën deputete të Kuvendit të Kosovës duke i uruar suksese dhe punë të mbarë.

Gjithashtu në emër të grupit të LDK-së shpreh kënaqësinë për dhënie të statusit të kandidatit Shqipërisë për BE.

Mirëpo nën të ndryshme e kam një çështje dhe ajo është gjetja e mënyrës për hapjen dhe deblokimin e rrugës “Bajram Llovca” në Zabelin e Sahit Ages të cilin arsyetim do ta japim më vonë.

Fatbardhë Selmani – në emër të grupit të anëtarëve të PDK-së propozojmë që të hyjë në rend të punës kjo kërkesë: Propozim- vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën e Hendikosit, sipas kërkesës të cilën ata e kanë dorëzuar në janar të këtij viti që shuma e këtyre mjeteve është 28 mijë 488 €.

Po ashtu propozoj që të ndahen mjete financiare edhe për dy shoqatat e tjera të cilat janë në krizë financiare e që janë ajo e Shurdhmemecëve dhe e të Verbërve. I lus anëtarët e KK-së që ta përkrahin këtë kërkesë të Hendikosit, sepse ata janë në krizë të thellë financiare dhe kanë shumë nevojë për mbështetje nga Komuna.

Zijadin Malqi- unë po e jap një arsyetim përkitazi me atë pse u kontestua pika tre dhe katër?

Mirëpo duhet kuptuar se kjo është një transefer i mjeteve financiare dhe mirë ka qenë të kalojë edhe në KPF, por ne shumë herë e kemi pasur këtë gjendje dhe krijohen situata që duhen mjete, sepse këto janë mjete brenda një programi dhe prej një kodi transferohen në kodin tjetër. Është shumë e nevojshme që të bëhet ky transfer, sepse nëse ne presim edhe një KPP dhe Kuvend do të jetë vonë, sepse mjetet janë shumë të nevojshme. Këto mjete janë brenda një programi ekzistues.

Besë Baftiu- edhe ne si grup i LVV e përkrahim iniciativën e grupit të PDK-së, sepse e dimë se në çfarë gjendje të rëndës është Hendikosi dhe shoqatat e tjera ai ajo e Shurdhmemecëve dhe ajo e të Verbërve. Për këtë arsyeje edhe ne kërkojmë që këto mjete të barten në këto kategori.

Riad Rashiti- unë e kam dorëzuar një kërkesë për herë të dytë në Drejtori të Financave dhe ende nuk kam marrë përgjigje! Kërkoj që drejtori të na informojë shkurtimisht me nivelin e të hyrave vetanake se sa është në këtë periudhë? Sipas informacioneve tona, del se kemi një inkasim të dobët të të hyrave vetanake. Kërkoj nga drejtori që të na informojë se sa është realizuar përqindja e të hyrave vetanake?

Për Inspeksionin e kam një pyetje, sepse dje ka filluar një aksion për rrënimin e disa objekteve të ndërtimeve pa leje, por kërkoj që ta di se a ka kompani të kontraktuar e cila e ka kryer këtë shërbim apo në çfarë forme ka ndodhur kjo?

Në vijim po theksoj se unë i kam drejtuar një numër të madh të kërkesave dhe deri më tash i kam drejtuar 17 kërkesa dhe asnjë përgjigje nuk e kama marrë me përjashtim të Zyrës së Prokurimit të cilën zyrë e falënderoj për bashkëpunimin e mirë që e ka pasur. Unë i lus edhe drejtoritë edhe kryetarin e Komunës që të na japin përgjigje, sepse e kanë obligim ligjor. Gjithashtu e falënderoj edhe Zyrën e Projekteve për realizimin e projektit (kanalizimin i ujërave atmosferike), në Lagjen e Zabelit i cili projekt është realizuar sipas planit dhe nuk ka ra në ndikim të askujt.

Kërkoj një informacion rreth shpenzimeve në Komunë, sepse kjo qeverisje po thirret në atë se Komuna e Gjilanit është në nivel zero sa i përket shpenzimeve, kurse ne vazhdimisht po vërejmë rritje enorme të shpenzimeve si është rasti i dezinfektimit e që është një rritje 700% e këtij shërbimi. A është kjo zvogëlim i shpenzimeve, ky shërbim me 700% rritje ? Gjithashtu kemi shpenzime për telefoni mobile, kurse ju keni deklaruar se do të ketë zero shpenzime për këtë kategori, por ju i keni bërë 34 mijë € shpenzime, veshmbathje 6 mijë 815€ E fundit është se në kohë të fundit janë ndërprerë shumë projekte nga Zyra e Prokurimit, por disa i ka ndërprerë vetë kryetari i Komunës, pa asnjë vendim dhe pa asnjë vlerësim të komisioneve mbikëqyrëse. Ia drejtoj edhe një pyetje Zyrës Ligjore dhe të jep sqarime se ka të drejtë kryetari i Komunës të ndërpres kontrata me kompani për ekzekutim të projekteve? Unë jam i bindur se kjo është jo ligjore, por kërkoj përgjigje nga Zyra Ligjore? Pse këto kontrata ndërpriten dhe a ka arsye apo jo ? Pse ndodhin këso parregullsi, në një anë ndërpriten kontrata, kurse në anën tjetër një kompani i merr 5 kontrata. Kërkoj edhe një përgjigje edhe për këtë rast?

Nevzad Isufi- unë i kam disa pyetje edhe për kryetarin, por edhe për organet tjera përgjegjëse të Komunës dhe së pari po filloj me kryetarin, por këto pyetje po i bëj nën të ndryshme,

Lutfi Haziri- përshëndetje për kryesuesen dhe të tjerët, por fillimisht i uroj të gjithë besimtarët për fillimin e muajit të shenjtë të Ramazanit të gjithë imamët e xhamive dhe të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit.

Besoj se lajm i mirë ishte mbrëmë, sepse certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve ka konfirmuar edhe vullnetin e qytetarëve të Komunës sonë dhe tash ne si Komunë kemi një numër të konsiderueshëm të deputetëve në Kuvendin e Kosovës.

Unë edhe herën e kaluar, por edhe tash po e them se ndryshimet në statut janë në proces, unë iu lus edhe si këshilltarë komunal dhe si grupe të këshilltarëve të sponzoroni ndryshime dhe të kërkonin që aty të vendoset koha e saktë e pyetjeve dhe kërkesave që pretendoni të jenë në statut. Deri më tash ky statut nuk i ka. Përvojën që po duam ta bartim nga Kuvendi i Kosovës në Kuvendin Komunal është përvojë e cila deri më tash nuk është bërë dhe për derisa nuk është, është forma e vjetër e komunikimit dhe e kërkesave dhe unë do t' i përmbahem. Unë jam për ta vendos një rregull punë, jam për dha atë rregull e vendosim bashkë dhe urdhëroni sponzoroni ose ne po e marrim si ekzekutiv veprimin dhe duhet caktuar saktë sa kohë duhet pasur në fillim të seancës, çfarë lloj pyetjesh si dhe koha e përgjigjes.

Nuk mund të vendosim që këtu të bëjmë pyetje dhe tash duhet të japim përgjigje. Unë e kam thënë se jam i hapur për t' u përgjigj, por nuk është normë. Bëne normë unë përgjigjem Sa i përket kërkesave tjera për një numër të tyre do të merrni përgjigje me shkrim, kurse për një numër të tyre siç janë subvencionet për çështje sociale, përfshirë Hendikosni, Shurdhmemecët dhe të Verbrit i kam kërkuar 100 mijë € subvencione në mënyrë që me Drejtorinë për Shëndetësi t' i përmbysim kushtet e banimit dhe kushtet me nevoja të veçanta. Kjo është arsyeje pse kemi kërkuar, sepse sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave, transferi i mjeteve nuk mund të ndodh në komuna nëse i kalon 5% të kërkesës dhe kjo është e drejtë e ministrit, por edhe pse është formale ne duhet ta bëjmë vendimin në mënyrë që ministri për Financa ta aprovojë ose edhe nuk e aprovon. Mirëpo besoj se nuk do të ketë problem, sepse mjetet janë tonat dhe është transfer i mjeteve dhe çdo gjë është në rregull.

Kërkesa për QKMF lidhet ngushtë me këto mjete edhe me ambulancën në Shurdhan, Cernicë, Zhegër dhe vendbanime tjera. Janë mjete me të cilat kërkohet të funksionalizohet QKMF-ja dhe shoqatat me kategori të veçanta. Mirëpo është edhe një shoqatë së cilës po përpiqem t' i gjej mjete dhe ka mbetur pa buxhet siç është Shoqata për Mbrojtje të Nënës

dhe Fëmijëve. Qendra ka mbetur pa buxhet dhe jemi duke u munduar për ta zbutur gjendjen me subvencione, por kryesisht me shërbime.

Nëse dëshironi për ta ndërprerë praktikën e keqe e cila u tha nga z. Fehmi Sylejmnai, unë jam për! Të shtyhen këto pika të gjitha të kthehen në KPF, të thirret seancë e veçantë dhe t' i diskutojmë, sepse jam ithtar i asaj që të vejmë disiplinë dhe rregull në punë dhe mos të bëjmë më përjashtime. Përjashtoni të gjitha pikat të cilat janë të papërgatitura këtu dhe të thirret një mbledhje e veçantë e KPF-së, një mbledhje e veçantë e Asamblesë Komunale dhe i vendosim të gjitha çështjet sipas procedurës.

Sa i përket kërkesave rreth inkasimit të buxhetit, borxheve, paralajmërimit të kompanive dhe kërkesave të tjera, iu njoftoj se në përputhje me mundësitë buxhetore dhe për shkak të obligimit ligjor për t' i servisuar obligimet nga viti 2010-2014, por faturat e vjetra më shumë se tri vjet është problem për t' i paguar ne dhe ato duhet të shkojnë në gjykatë. Ne jemi duke e përgatitur dosjen e obligimeve në mënyrë që gjykata ta jep vendimin final.

Deri më tash 1.8 milion euro nga të hyrat komunale i kemi servisuar borxhe, të cilat mjete nuk janë alokuar nga ndonjë burim tjetër, por duke përfshirë edhe atë bartjen e cila ka qenë e inkasuar nga viti i kaluar. Paralajmërimi për uljen e shpenzimeve i ka prek të gjitha kategoritë duke i përfshirë edhe kompanitë të cilat kanë kontrata në kornizë. Nuk është asgjë tjetër, por ne nuk kemi mundësi buxhetore për të paguar 200 mijë €, sigurim të objekteve, nuk kemi mjete të mëdha për ta paguar mirëmbajtjen e parqeve dhe gjelbërimeve, nuk kemi mjete për ta rregulluar mirëmbajtjen e trotuareve dhe ndriçimeve, sepse kemi filluar një politikë të reduktimeve. Unë e di që reagimi qytetarë është pse nuk ka ana e djathtë ndriçim, por ka ana e majtë, por është politika e tillë e reduktimit të shpenzimeve. Është politikë e ashpër e disiplinës buxhetore, nuk ka rritje të shpenzimeve. Na u përmend një shërbim për dezinfektim, është vendimi që ky shërbim do të anulohet dhe e falënderoj shumë këshilltarin komunal rreth shumës që ka qenë herën e kaluar. Kërkesa e tij më ka bërë që të kërkoj hetime në Zyrën e Prokurimit dhe do të vazhdoj që të kujdesem sipas detyrës zyrtare në mënyrë që mos të lejoj asnjë devijim në proces. Ky vit buxhetor është i ashpër për neve dhe do ta përballojmë, sepse edhe ne do të kishim pasur mundësi ato 1.8 milion euro t' i shpenzojmë për investime kapitale, por nganjëherë vendimet popullore duhet lënë anash.

Edhe te transporti i nxënësve edhe te numri i arsimtarëve dhe te reduktimi i klasës së XIII dhe te mos shpallja e konkursit për arsimtar të gjitha ka përgjigje. Ne nuk do të shpallim konkurse për arsim derisa të gjithë punëtorët e arsimit me kontratë do të sistemohen. Gjithashtu edhe transport për nxënës nuk do të bëjmë derisa kontrata nuk është ligjore, kontrata duhet të jetë ligjore. Të gjitha gjetjet që i kemi do t' i japim të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Karshi të tërë këtij procesi po mundohemi të sillemi me mundësitë që i kemi buxhetore në përputhje me ligjin. Nuk ka shpenzime në Komunë, investimet janë ndarë nga kategoria e shpenzimeve dhe të mallrave. Unë i kam reduktuar të gjitha shpenzimet sa i përket telefonisë, të ushqimit, asaj që quhet reprezentacion, udhëtime etj. Këto shpenzime janë minimizuar, sepse ju e dini sa ka qenë niveli i shpenzimeve dhe ne jo pse jeni këtu, por e dini se 820 mijë euro, kanë shkuar në shpenzime në tri kategori të cilat janë shumë të mëdha për një Komunë si është Gjilani dhe këto shpenzime janë të papërbalueshme dhe është konsum i tepruar. Këto janë çështje që duhet të zgjidhen dhe deri atëherë ne duhet të angazhohemi seriozisht për ta përfaqësuar interesin qytetarë dhe të gjitha vendimet e Komunës janë publike dhe të gjitha angazhimet e ekzekutivit do të bëhen publike.

Bujar Nevzadi- atë që po thotë kryetari i Komunës këtu, unë jam për ta mbështet dhe atë jo si individ (si Bujar), por edhe si grup i këshilltarëve. Mirëpo kryetari diçka tjetër po thotë, kurse diçka tjetër po vepron në praktikë! U përmenden disa çështje të cilat për mua janë të kapshme dhe të pranueshme, por nuk e përmendi çështjen e të punësuarve në administratë të

cilën e ngrita unë. Listën e kam kërkuar që tre muaj, kurse nga ana tjetër janë larguar njerëz të cilët janë të burgosur politikë, ushtarë të UÇK-së dhe në vend të tyre keni sjell njerëz të cilët i kanë të gjitha kushtet. Pse nuk thuhet kjo? Thuhet jam i barabartë, por kryetari nuk është i barabartë, sepse gjashtë emra janë sjell dhe që të gjithë janë anëtarë të kryesisë së LDK-së. Kryetari këtu nuk është kryetar i LDK-së, por është kryetar i Komunës së Gjilanit. e dyta nuk ka ndriçim në rrugën kryesore dhe sheshi kryesor kanë kaluar tre muaj dhe nuk ka ndriçim.

Riad Rashiti- unë mbështes kryetarin nëse i konkretizon ato që i tha dhe jam në pajtim që kryetari të kërkojë hetime dhe është mirë që të vazhdojë kështu. Por kërkoj që me rastin e formatizimit të qeverisë t' i ketë parasysh gjërat të cilat plotësisht kanë dështuar! Sipas parashikimeve deri në fund të vitit do të ketë të hyra nga inkasimi 1 milion euro më pak, prandaj është mirë që ndërmerrni hapa në këtë drejtim, sepse buxheti i planifikuar të jetë 1 milion më pak nuk ka ndodhur asnjëherë pas luftës.

Ten destinimi i subvencioneve prej 100 mijë €, në këtë vendim-propozim neni 2, transefri i mjeteve lejohet për t' i ndihmuar familjet skamnore për strehimin e tyre dhe nuk janë të planifikuara për shoqatat të cilat i tha kryetari. Çështja tjetër është rritja e shpenzimeve dhe unë e di se shpenzimet janë edhe për mallra dhe shërbime dhe punë të tjera ajo është shpenzim dhe të thuhet se shpenzime është zero, është krejt tjetër prej asaj që është zvogëlim. Mirëpo pajtohem se diku ka zvogëlim të shpenzimeve, por ka shpenzime marramendëse të disa kategori të tjera. Së paku duhet të jetë një përgjegjësi kur epen krahasime me raportet e tjera.!

Lutfi Haziri- nuk jam i interesuar në asnjë mënyrë për të shkaktuar polemikë, por edhe listën e të punësuarve dhe listën e projekteve edhe listën e buxhetit, por unë i përmbahem parimit të dy niveleve. Po flasim për obligimet e Komunës në raport me operatorët, qytetarët të cilat kemi filluar t' i servisojmë dhe nuk asnjë rast që qytetarët i kanë obligime Komunës dhe janë duke ndërtuar politika për inkasim të mjeteve në Komunë. Mirëpo besoj se vitin e kaluar planifikimi i buxhetit për këtë vit edhe më tutje vazhdoi të besoj se nuk ka qenë real!

Vlera e tatimit në pronë është jashtëzakonisht e lartë sipas çmimit të tregut, por unë jam i obliguar për ta zbatuar këtë tabelë dhe këtë buxhet që e kemi.

Do të angazhohem për ta rrit inkasimin sipas vitit buxhetor 2014 dhe do të angazhohem për ta rrit inkasimin e borxheve e që tash më në Komunë e që iu kanë afruar vlerës 9 milion euro që kanë ndaj Komunës. Edhe listën e projekteve dhe listat e tjera që janë edhe buxheti edhe projektet kapitale të gjitha janë miratuar nga ky Kuvend, por jo me këtë përbërje do të thotë me legjislaturë tjetër. Ju e dini që ndryshimin mund ta shkaktojë deri në masën 20% vetëm me vendim të Qeverisë, kurse Qeveria e ka bërë një rishikim të lehtë në mars, por na e ka reduktuar buxhetin për 15% për shkak të rritjes së rrogave. Ne dhe më tutje po presim që të kemi mundësinë e rishikimit dhe me rishikim dhe atëherë do të kemi mundësi për të ndryshuar diçka, kurse deri atëherë nuk mendoj fare që ta shkeli ligjin. Unë kam presion të madh nga ky grupi i im, sepse këta kërkojnë ndryshim, por nuk mund ta shkeli ligjin në asnjë mënyrë, sepse buxheti është miratuar dhe lista e projekteve është miratuar. Këto që i kemi miratuar është normë dhe duhet zbatuar ligji dhe do të punohet sipas ligjit.

Sa i përket shpenzimit të mallrave dhe shërbimeve e thash se 15% janë reduktuar mallrat me një vendim të kryeministrit, kurse ne po përpiqemi që pjesën e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve ta ndajmë drejtë për të gjitha kategoritë. Asnjë mjet nuk është nga shërbimi i mallrave për të ardhura personale ashtu si ka qenë me kontrata në vepër.

Kategoria e shpenzimeve vazhdoi t' iu them se është në pikën zero dhe ju do të bindeni dhe do ta shihni! Ajo që u përmend 6 mijë € për veshje të zyrtarëve ka të bëjë me Drejtorinë e Administratës dhe personelin sipas kërkesës së drejtorit i cili edhe rregullores së miratuar nga

ish kryetari dhe Asambleja Komunale. Çdo dy vjet Komuna ka të drejtë për t' i ndarë një pjesë të mjeteve për këtë qëllim. Është shfrytëzuar kjo e drejtë dhe asgjë tjetër nuk ka! Ne i kemi bërë përgatitjet për shoqatat si Shurdhmemecët, të Verbërve dhe jemi duke i ndërtuar politikat për këtë qëllim, por pa i lejuar KK dhe Qeveria mjetet, mjete nuk do të ketë. Në momentin që lejoni dhe lejon edhe ministri, mjetet barten dhe jam i interesuar që këto çështje t' i zgjidhi në janar dhe jo në qershor. Për vitin e ardhshëm këto kategori do të kenë buxhet dhe të gjitha mjetet do t' i barten në janar dhe për një vit buxhetor më nuk merremi me shoqata me kategori të veçanta.

Valentinë Bunjaku – Rexzhepi – duhet të kemi mirëkuptim kësaj radhe, por herëve tjera duhet pasur kujdes dhe çdo pikë e rendit të punës të propozohet sipas procedurave. Ju lutem të deklaroheni se kush është për këtë rend të punës?

Aprovohet rendi i punës me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit.

Aprovimi i procesverbalit-

Bajram Hasani- faqe 13 ku përmendet fjala revidim ku thuhet: mos po ikni fjalës revidim” dhe jo “po i iku unë fjalës revidim”!

Avdyll Aliu- faqe 5 është theksuar se anëtarët e Kuvendit shkojnë në pushim 5 minuta, mirëpo këtu është rasti kur një këshilltar komunal del në foltore dhe e pengon punën e Kuvendit, por nuk e di se ka qenë të evidentohet ky rast apo jo!

Leonorë Bunjaku- në faqe 3 duhet të thuhet: “ përkundër përpjekjeve në zgjidhjen e problemeve” dhe jo “edhe përkundër problemeve në zgjidhjen e këtyre problemeve”.

Aprovohet procesverbali me këto vërejtje, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

2 Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2.1. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Gjilanit 2015-2017

Riad Rashti- KAB cila është prezantuar sot para Këshilltarëve Komunal, ndryshe mund ta quajmë lirisht fontanë Dëshirash e Qeverisjes Lokale. Vërtetë nuk është e lehtë për t' i kuptuar nga të gjithë, përmbajtjen e kësaj KAB-i

Së pari ne e kuptojmë drejt se kjo kornizë duhet në parim të miratohet për çdo vit nga Kuvendi Komunal.

Mirëpo ndryshimet e bëra në këtë kornizë, me synimin për rritjen prej 5 milion eurove të buxhetit komunal për në vitet e ardhshme, me guxim të plotë e themi se është vetëm një fontanë dëshirash.

Ne e kemi analizuar mire këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore, ku në secilin sektorë shihet se kemi të bëjmë me një rritje paushallë të shifrave financiare, pa e analizuar aspak mire faktorët dhe mundësitë reale për t' u realizuar ky buxhet për komunën e Gjilanit për vitet e ardhshme.

Nëse nisemi nga fakti i planifikimit tuaj, ku keni paraparë të keni rritje të të hyrave vetanake në buxhetin e komunës nga 3,780,000 sa është në vitin 2014 në 4,059,953 për vitin 2014, pra një rritje prej rreth 279 mijë euro, e që realisht nuk duket një rritje e madhe, mirëpo me këtë angazhim dhe efikasitet të kësaj qeverisje lokale, jo që nuk asnjë gjasë të realizohet ky planifikim me këtë rritje të paraparë, por do të kemi rënie drastike në të hyrat vetanake në buxhetin komunal, ku për këtë shembulli më i mire është, niveli i inkasimit

për këta 6 muaj të pare të qeverisjes suaj, dhe me këtë nivel të ulët të inkasimit, deri në fund të vitit, do të kemi hiq më pak se rreth 1 milion euro të hyra vetanake, e çka do të thotë se ju me këtë qasje të inkasimit, ju do të mund të realizoni vetëm rreth 2.8 milion nga 3.8 milion sa është planifikimi për këtë vit.

Në këtë kornizë e keni theksuar rënien e taksave dhe të hyrave nga bizneset në buxhetin e komunës në dy vitet e fundit, duke kritikuar politikat dhe vendimet e asamblesë së kaluar komunale, përmes së cilave janë liruar nga taksat komunale të gjitha bizneset në komunën e Gjilanit. Po ashtu keni konstatuar se këto kanë qenë politika jo transparente dhe jo fer.

Kjo është vërtet një vlerësim qesharak i juaji, si është e mundur që tani ju të dilni me kundërshtim për lirim të taksave për bizneset? A jeni ju a po më duket, që gjatë fushatës keni premtuar lirin dhe uljen e taksave, edhe kur ato kanë qenë krejtësisht të eliminuara, sikurse rasti i tregtarëve në tregun e gjelbër, kur ne në qeverisjen e kaluar, i patëm liruar të gjithë tregtarët nga taksa komunale, kishin zero euro takes, ndërsa në fushatë kryetari Haziri premtonte ulje të taksës?

Bizneset duhet edhe më tutje të përkrahen nga komuna, ato kanë nevojë çdoherë për mbështetje dhe lehtësira të ndryshme. Nëse kjo bëhet nga komuna, atëherë ato rriten dhe fuqizohen, krijon shumë vende të reja të punë dhe gjenerojnë shumë të ardhura për familjet tona.

Te planifikimi i shpenzimeve Komunale shihet se ka tendencë të rritjes

Edhe te shpenzimet është mjaft interesant, ku vazhdimisht kryetari i komunës ka thënë se do të ketë zvogëlim të shpenzimeve, ndërsa në këtë kornizë afatmesme shihet është planifikuar rritje e tyre, duke filluar nga:

Pagat dhe mëditje , është planifikuar rritje e shpenzimeve për 20.1%

Mallrat dhe shpenzimet rritje për 12.67%

Subvencionet thuhet do të jenë 6% në totalin e shpenzimeve të përgjithshme, e që shihet se ka rritje të jashtëzakonisht të tyre, nga 558,800 në vitin 2014 sa janë, ato i keni planifikuar në 1,541,700 euro, rritje për 300%. Kjo është vërtet një tregues tepër negative për buxhetin e Komunës së Gjilanit

Investimet kapitale janë paraqitur rritje të pabazuara, sepse janë planifikuar të financohen nga te hyrat vetanake , e që në realitet të hyrat vetanake kanë rënie drastike dhe kështu që këto investime kapitale edhe nuk mund të ndodhin në realitet por mbesin fontanë dëshirash të realizuara.

Sa i përket investimeve kapitale të planifikuara më detajisht e që thuhet se ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Shihet se në projektet e planifikuara nga

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, për tri vitet e ardhshme nuk ka planifikuar asnjë projekt të vetëm që do të ndikonte në rritjen e shfrytëzimit të potencialeve për të ndikuar në nxitjen e rritjes ekonomike. Në këtë drejtori janë planifikuar fonde vetëm për shpronësim të tokës për interes publik.

Nuk është paraparë asnjë investim për vazhdimin e krijimit të zonave ekonomike, për ngritje të kapaciteteve për të rritur investime private në komunën e Gjilanit, nuk është planifikuar ndonjë projekt për bashkëpunim ndërkufitar etj.

Te tatimi në pronë (e shënuar taksa e pronës nuk qëndron, sepse është tatim) ka rritje të të hyrave – buxhetit të planifikuar për vitet e ardhshme, ndërsa kryetari i komunës ende bënë fushat zgjedhore duke deklaruar se do të ketë ulje të tatimit në prone.

Dënimet në komunikacion, shihet se janë planifikuar të rriten të hyrat nga dënimet në komunikacion për 130%, këtë logjik aspak nuk e kam të qartë pse?

Në këtë vit kanë qenë të planifikuara 150 mijë euro, ndërsa viteve tjera deri në 340 mijë euro, nuk e kuptoj se si e keni planifikuar ju komuna rritjen e buxhetit nga rritja e dënimeve në komunikacion. A do të krijoni polici komunale ju apo si është plani i juaj që

kjo të realizohet në praktikë?

- Dhe një tjetër çështje mjaft e ndjeshme, është se në synimet e kësaj kornize, te përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, nuk keni planifikuar për vitet e ardhshme asnjë euro mbështetje personave me nevoja të veçanta, që janë mbi 1 mijë persona në komunën e Gjilanit?

- Duke pasur parasysh të gjitha këto çështje por edhe të tjera, shihet dhe vërtetohet shumë lehtë dhe qartë se kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore, është një planifikim jo Professional, i bazuar në tregues dhe indikator joreal ekonomik, me një orientim të paqartë zhvillimor për komunën e Gjilanit.

Në këtë kornizë buxhetore, janë paraqitur krejtësisht politika tjera financiare në krahasim me ato që janë prezantuar nga ana e kryetarit të komunës së Gjilanit.

- Është thënë do të ketë rritje të të hyrave, ndërsa kemi ulje drastike të tyre

- Është thënë se do të ketë ulje të shpenzimeve, ndërsa kemi rritje enorme të tyre

- Është thënë se do të kemi zvogëlim të subvencioneve, kemi rritje 300%

- Është thënë se do të kemi ulje të tatimit në prone, ndërsa kemi planifikim të rritur për vitet e ardhshme

- Është thënë se do të kemi ulje të pagave dhe mëditjeve, ndërsa kemi rritje për 20.1%

- Është thënë se do të kemi zvogëlim të mallrave dhe shërbimeve, ndërsa kemi rritje për 12,67%

- Është thënë se do të ketë ulje të taksave për bizneset, ndërsa kemi rritje të taksave

- Është thënë se ka zero shpenzime për kartela dhe mbushje të telefonit, ndërsa ka dhënë tender mbi 34 mijë euro për dy vite

- Është thënë se nuk do të ketë më pak tenderë përmes kuotimit, ndërsa kemi rritje të % së tyre

- Është thënë që do të respektohen procedurat e tenderimit, ndërsa i kemi gjetur dëshmitë e sakta se ka pasur shkelje procedural dhe ligjore, me vepra penale. Ku janë goditur privatisht me kompaninë punët, janë kryer e tek pastaj kanë filluar procedurat...

- Është thënë se do të ketë kosto më të vogël të projekteve, ndërsa ato të njëjtat kanë rritje në këtë vit, sikurse shpenzimet për projektin e dezinfektimit, ku viteve të kaluara ky shërbim kishte kosto mesatare vjetore 8 mijë euro, tani ka mbi 53 mijë euro, rritje 700%, ndoshta edhe mushkonjat janë rritur e janë bo arusha këtë vit.

Pra, kjo qeverisje e juaja, fatkeqësisht krejt tjetër çka flet, tjetër mendon, tjetër vepron, tjetër dëshiron e krejt tjetër çka realizon.

Valentinë Bunjkau –Rexhepi- ka akuza mjaft të pabaza, sepse në KPF është thënë se KAB është kopje e vitit të kaluar, kurse tash po thuhet se gabime trashanike.

Bajram Hasani- te pika 2 lidhur me prioritete strategjike zhvillimore, sidomos te regjistrimi i bizneseve ku thuhet se janë të regjistruara 3 mijë biznese të cilat operojnë në Komunë. Unë kërkoj që të jetë një raport më detal dhe të dihet se sa biznese janë funksionale dhe sa prej tyre i nënshtrohen obligimeve komunale?

Gjithashtu në këtë Kornizë thuhet se 50% e ndërmarrjeve janë tregtare, 13% sektorit të shërbimeve, kurse 10% sektorit të prodhimit dhe 27% të tjera.

Mirëpo unë kërkoj nga kryetari dhe drejtori që rëndësi të veçantë t' i japin sektorit të prodhimit (ndërmarrjeve prodhuese), si në aspektin e detyrimeve financiare dhe t' i bëjmë lehtësime apo subvencione konkrete dhe t' i japim rëndësi të veçantë prodhimit, sepse me prodhim do të ketë zhvillim më të shpejtë të Komunës.

Nevzad Isufi- edhe ne kemi nevojë për disa qartësime për këtë Kornizë për të cilën po flasim. Ne vazhdimisht po flasim për prioritet e Komunës si në shëndetësi, arsim dhe sektorë të tjerë, por sipas shifrave nuk vërehet se ekziston një prioritet i tillë. Si shembull është shëndetësia, sepse nga kodi i mallrave dhe shërbimeve ka rritje vetëm 21% më shumë se ato të Zyrës së Kryetarit. Sipas shifrave në Zyrën e Kryetarit janë 350 mijë €, kurse për shëndetësi janë 423 mijë €. Mandej në Zyrën e Kryetarit janë 29 të punësuar, kurse në shëndetësi i kemi 290 të punësuar (shëndetësi primare), prandaj ky është një disproporcion tejet i madh.

Diçka e ngjashme është edhe në DKA e cila drejtori i ka 810 mijë € për mallra dhe shërbime e që shihet se ka mjete më shumë se arsimit para fillor, fillor dhe i mesëm. Gjithashtu nëse e bëjmë numrin e të punësuarve në këtë drejtori vërehet se është një disproporcion i madh.

Në faqen 13 te Zyra e KK-së, figuron, numri i të punësuarve zero, kurse pagat 175 mijë €, prandaj shtrohet pyetja se çka po ndodh me këto shifra, sa janë të sakta?

Në faqen 7 kemi grande nga të hyrat vetanake për vitin 2014 i kemi 165 mijë €, dhe thuhet pagesa të tjera? Mirëpo edhe në një kod tjetër është e njëjta shumë, por nuk ka sqarime shtesë? Në vitin 2015, 2016 dhe 2017, nuk ekziston asnjë shifër. Te subvencionet për të cilat po flitet shumë, por t' i krahasojmë subvencionet e vitit 2013 e që kanë qenë të parapara 643 mijë €, kurse për vitin 2014 i kemi 627 mijë €. Nga këto shifra nuk duket se kemi rritje të subvencioneve, por kemi zvogëlim. Mendojmë se duhet dhënë përparësi subvencioneve, kurse nëse mendojmë se duhet kursyer, atëherë kursimi duhet të bëhet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe këto kursime të barten te subvencionet.

Te numri i nxënësve që përfitojnë nga kabinetet apo laboratorët për vitin, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 është një zvogëlim drastikë në vitin e fundit, sepse prej mbi 4 mijë 100 € në vitin 2014, bie në vitin 2017 në 1734 €, prandaj nuk e kuptojmë pse ky ndryshim kaq i madh dhe kërkojmë sqarime për këtë?

Këto janë vërejtjet tona për KAB.

Shukrie Rapuca- KAB është e përpiluar me fjalë të mira e rritje të financave, sidomos për disa sektorë, por nuk është bazuar fare në burimet reale financiare për periudhën 2015-2017. Unë po i theksoj vetëm disa shembuj për ta vërtetuar këtë fakt:

- Në arsim tabela 7 dhe 8 faqe 13 dhe 14, numri i punëtorëve është i njëjtë 1835 ashtu si ka qenë. Fondi i pagave, parashihet të rritet për 2 milion e 236 mijë €, kurse mallrat dhe shërbimet rriten për 370 mijë €.

Në Bujqësi- subvencionet planifikohen të rriten për 804 mijë e 500 €

Investimet kapitale për 95 mijë €.

Mirëpo që të gjitha parametrat ekonomik qoftë në nivel të Kosovës, qoftë në nivel të Komunës nuk i sigurojnë financat e parapara për këtë rritje, të cilin fakt po e argumentoj.

Grandet nga niveli qendror planifikohen të rriten për 27-29% dhe të hyrat vetanake pritet të rriten vetëm 2-7% (subvencionet merren nga të hyrat vetanake).

Në anën tjetër në arsim numri i nxënësve po zvogëlohet për çdo vit, por edhe numri i punëtorëve po ashtu, kurse fondi i pagave po rritet për 2 milion e 200 mijë €, prandaj cila është logjika e kësaj kornize?

Zijadin Maliqi- unë mund të them se KAB është një dokumenti i rëndësishëm për Komunën e Gjilanit. KAB i paraprinë dhe nuk është planifikim i buxhetit, por i paraparin planifikimit të buxhetit për vitet e ardhshme, sidomos i paraprin planifikimit të buxhetit për vitin 2015, sepse në vitin tjetër përsëri aprovohet KAB për vitet në vijim. Kjo kornizë i dërgohet MEF-it dhe nga ministria caktohen kufijtë buxhetor, pastaj kryetari i Komunës e formon komisionin për hartimin e buxhetit për vitin 2015 dhe me atë rast mund të diskutojmë më hollësisht rreth të gjitha këtyre kategorive buxhetore.

Kjo është një kërkesë e Komunës sonë për plotësim sa më të mirë të nevojave të sajë e të cilën e përkrahim, sepse e kemi një rritje të hyrat vetanake prej 2.2 – 4.7%. Mirëpo ne nuk duhet të merremi me të hyrat vetanake, sepse ato janë mjete tona dhe ne e bëjmë përcaktimin e tyre se ku duhet të shpenzohen?

Te grandet e kam vërejt se kryesisht është zbatuar formula edhe për Komunën e Gjilanit dhe presim që të kemi rritje të grandeve. Më detalisht me këtë do të merremi kur të aprovohet buxheti i vitit 2015 dhe mendoj se KAB duhet të aprovohet me koncenzues të plotë.

Selami Xhemajli- edhe ne grupi i AAK-së e përkrahim këtë KAB, kurse vërejtjet tona do t' i japim në kohën kur të bëhet planifikimi i buxhetit për vitin 2015.

Për derisa është kornizë edhe ne e përkrahim.

Arben Mehmeti- unë nëse më duhet ta kritikoj dike duhet ta kritikoj opozitën, sepse përmbajtja kryesore e kësaj kornize është nga qeverisja e kaluar. Nuk mundet as drejtori i ri tash ta bëjë ndonjë përmbajtje tash në tërësi ndryshe përderisa është i njëjti staf i cili ka hartuar në të kaluarën këtë dokument. Mirëpo drejtoria përkatëse na e ka sjell një dokument dhe na e ka dhënë mundësinë për t' i marrë vendimet adekuate. Mirëpo unë nuk pajtohem që KK të vazhdojë të shndërrohet në instrument teknik në këtë rast të ekzekutivit. Është vërejtje për drejtorët të cilët nuk janë këtu, është një jo seriozitet, sepse nuk qëndrojnë këtu, kur duhet të jenë prezent në seancë.

Në këtë kornizë të mallrat dhe shërbimet i kemi një shumë e cila përsëritet çdo vit të KK dhe janë 25 mijë € për vitin 2014, 20 mijë € bie në vitin 2015 dhe vazhdimisht kjo shumë shkon duke u zbritur. Unë jam që kjo shumë për KK të rritet dhe më 2015 të 25 mijë € dhe kështu për çdo vit të ketë rritje nga 5 mijë €.

Unë po e jap këtë propozim dhe janë njerëzit kompetent që ta vlerësojnë se ka mundësi të zbatohet ky propozim apo jo ?

Mandej kur flitet për subvencione mua më duket absurde pse KK nuk ka subvencione dhe për mua kjo është jo serioze. Nuk figuron në KAB sa i përket subvencioneve për Zyre të KK-së. Unë propozoj që edhe për KK të parashihen së paku nga 10 mijë € subvencion për Zyrën e Kuvendit.

Bujar Nevzadi- unë edhe në KPF e kam thënë se KAB është kopje e qeverisë së kaluar dhe këtë e vërtetoi Arbeni. Unë e kam bërë krahasimin në shtëpi dhe e kam vërejt se është e njëjtë. Aty ku keni prek në shifra e keni bërë keq e të cilat gjëra i tha Riadi.

Këtu nuk duhet të shkruhet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, por Kuvendi Komunal,

por edhe nuk duhet të figurojë emri i drejtorit të financave, por emri i kryetarit të Komunës. Në faqen 7 është shkruar : “pagesa e taksës së pronës”, prandaj duhet ta dalloni taksën nga tatimi në pronë. Në faqe 8 nuk janë planifikuar dhuruesit (donatorët), kurse në media thoni se Gjilani ka shumë dhurues. Te faqja 14 te kategoria mallra dhe shërbime është 15%, kurse në investime kapitale 19%. Në qeverisjen e kaluar ka pasur 27-30% investime kapitale dhe është mirë drejtori të na informojë se ku janë të planifikuara këto subvencione?

Riad Rashiti- sa i përket propozimit që KK të ketë fond Komunal të ketë buxhet ose subvencione, kjo absolutisht nuk do të duhej të ndodhte, sepse të gjitha kërkesat që na drejtohen neve si KK, janë drejtoritë përkatëse të cilat i përgjigjen kërkesave të shtruar nga individët apo institucionet.

Arben Mehmeti- unë e theksova se duhet të ketë një fond të tillë, sepse ne si Kuvend, kemi dëshirë për ta bërë ndonjë punë të mirë. Mirëpo vlerësimi duhet dhënë me kompetencë nga drejtori se a ekziston ndonjë mundësi e tillë apo jo?

Valentinë Bunjkau –Rexhepi- edhe unë jam e interesuar shumë që të realizohet këtë që e propozoj z. Arben Mehmeti, sepse edhe ne kemi obligime ndaj qytetarëve. Drejtoritë përkatëse janë, por ato do ta vazhdojnë punën e tyre, por brenda mundësive ligjore edhe do të ishte mirë që ta kemi një fond.

Avdyl Aliu- sa i përket debatit për KAB, të organizuar nga KK përkatësisht nga KPF mund të themi se ka qenë një debat i kënaqshëm si nga numri i qytetarëve pjesëmarrës ashtu edhe për nga interesimi i tyre për këtë çështje. Kjo nuk do të thotë se jemi super të kënaqur me këtë pjesëmarrje në këtë debat edhe pse krahasuar me të kaluarën ka dallim si nata me ditën. Dëshirojmë që qytetarët tanë të jenë pjesë e pandarë e këtij procesi dhe të njëjtit të kontribuojnë në përmbyllje efikase të kësaj kornize.

Në këtë rast në emër të grupit të LDK-së në Kuvend i falënderoj qytetarët për pjesëmarrje në këtë debat të organizuar ditë më parë.

Me këtë kornizë synohet që të ketë një zhvillim ekonomik dhe e tërë kjo në funksion të mirëqenies së qytetarëve të Komunës sonë. Ky projekt buxhet për vitin 2015 reflekton edhe rritje të subvencioneve sidomos nga sfera e bujqësisë, kulturës, rinisë dhe sportit. Pjesë e pandarë e këtij buxheti është edhe lista e gjatë e projekteve kapitale për vitin 2015 nga të gjitha fushat e infrastrukture si në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit dhe shërbimeve publike. Me fillimin e jetësisimit të këtij planifikimi nga fillimi i vitit 2015, besoj se do të fillojë edhe një rigjenerim i zhvillimit ekonomik, mirëqenies dhe progresit në të gjitha fushat e jetës së qytetarëve, duke i ndihmuar edhe bizneset e Komunës sonë e të cilat do të ndihmojnë në rritjen e vendeve të punës.

Salih Kçiku- së pari po i jap disa përgjigje. Z. Riad Rashti ka kërkuar që të njoftohet për të hyrat vetanake të Komunës për këtë periudhë, por po theksoj se unë ia kam dërguar në adresën elektronike, por edhe e lus që herëve të tjera kërkesa të bëhet në adresë zyrtare dhe jo private.

Sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve ne raportin tre mujor e kemi analizuar dhe i kemi cek të gjitha. Të hyrat vetëm në muajin e pestë kanë një rënie për shkak të zgjedhjeve të tjera janë 98.6%.

Tash e kemi raportin 6 mujor dhe do të shihet se shpenzimet janë dukshëm më të vogla në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Subvencione sa i përket Kuvendit nuk ka mundësi, sepse nuk lejon ligji. Në vijim të fjalës së tij z. Kçiku e sqaroi në mënyrë detale, KAB, të cilin dokument anëtarët e Kuvendit e kanë në materialin e seancës.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja kërkon që të aprovet pika 2.1 e rendit të punës.

Aprovet pika 2.1 e rendit të punës: Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Gjilanit 2015-2017, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit.

Në ora 12 deri në ora 13 anëtarët e Kuvendit shkojnë në pushim të drekës.

2.2 Propozim vendimi për emërimin e Komisionit për plotësimin e emërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Gjilanit

Valentina Bunjaku- Rexhepi – pas pushimit seanca i fillon punimet, kurse kryesuesja kërkon që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në punimet e seancës së tetë.

Sekretaria konstatoi se të pranishëm në pjesën e dytë të punimeve të seancës ishin 29 anëtarë, kurse 6 munguan.

Debatin për këtë pikë e hapi kryesuesja e Kuvendit e cila e bartë fjalën tek anëtarët e Kuvendit.

Myzaferre Ismajli- së pari urime për dy deputetet e Kuvendit të Kosovës, por edhe urime të gjithë besimtarëve muaji i Ramazanit.

Sa i përket kësaj pike të rendit të punës është mirë që kur të bëhet emërtimi i rrugëve t' i kemi parasysh disa emërtime standarde si rruga e Ferizajt, rruga e Prishtinës, ose e Bujanocit, të mbesin me këta emra. Emërtimet e tilla janë edhe në vende të tjera të botës si p.sh rruga e Tiranës, rruga e Kavajës e Elbasanit etj. Po kështu ndodh edhe në vende të tjera të botës si Zvicër është rruga e Bernit, Lozanës, etj.

Pajtohem që një e më shumë rrugë të mos emërtohen me emër të një personi, kurse në anën tjetër shumë personalitete, mbesin për pa u përfshirë në emërtime të rrugëve dhe shesheve.

Bjaram Hasani – vendimi për emërimin e këtij Komisioni, po e shoh se nuk janë emrat konkret, por shkruhet vetëm profesioni, prandaj pajtohem me kolegun nga LVV që ky komision të formohet, por të jenë emrat konkret për ta ditur se për kë ne po votojmë?

Në këtë komision janë përcaktuar vetëm ekspertët dhe lëmitë e tyre, por unë kërkoj që këtij komisioni t' i shtohet edhe profesionisti inxhinier i komunikacionit. Inxhinieri i komunikacionit është profesionist adekuat për t' i ranguar rrugët ose prioritetet e tyre.

Të gjitha rrugët nuk mund të rangohen njëjtë, por duhet dalluar rrugët kryesore me emra më eminentë të kaluarës sonë. Për këtë arsyeje kërkoj që në këtë komision të jetë edhe profili i inxhinierit të komunikacionit.

Jehonë Hyseni- sa i përket emërimit të këtij komisioni dhe komisioneve tjera, unë mendoj se këto materiale duhet të sillen të kompletuara dhe në çdo propozim - vendim të jetë edhe dëshmia për marrjen e këtyre vendimeve. Duhet ditur se në çka bazohet nxjerrja e një vendimi, në cilin ligj është në cilin nen apo udhëzim administrativ është bazuar? Çdo vendim duhet të ketë bazë ligjore dhe të citohen nenet në bazë të cili ligj është nxjerr ai vendim?

Arben Mehmeti- sa i përket këtij vendimi unë i kam rezervat e mia në raport me këtë vendim për arsye se ne si KK jemi para një akti pothuaj se të kryer. Neve na sevohet një dokument me profesione të caktuara, por edhe me emra të caktuar e që për mua është e pa justifikueshme. Nëse ne jemi Kuvend dhe jemi organi më i lartë i kësaj Komune, ne jemi ata që duhet bërë formulën dhe ta caktojmë profesionin. Nëse ka ligje që i specifikon profesionet e një komisioni ne nuk mund ta ndryshojmë ligjin.

Nëse ka udhëzim administrativ që i ka specifikuar profesionet e këtij Komisioni ne nuk mund t' i ndryshojmë, por vetëm duhet t' i ekzekutojmë. Ne si KK, konsideroj se duhet ta propozojmë komisionin për pa i specifikuar profesionet e caktuara dhe në këtë rast duhet pëlqim i 2/3 të anëtarëve të Kuvendit dhe duhet një pajtim i subjekteve kryesore të këtij Kuvendi. Ne këtë çështje e kemi pasur edhe më parë dhe këtë proces e kemi kryer në mënyrën më të mirë, por tash është rasti që plotësimi të bëhet edhe më mirë, sepse ka ligje të cilat e specifikojnë shumë mirë këtë çështje. Unë jam për atë që ne si KK e kemi të drejtën për ta nxjerr një komision i cili mund t' i ketë 11 anëtarë, 15, 17 dhe në një mënyrë nuk duhet të ketë kufizime, sepse duhet aprovimi i 2/3 dhe duhet të jenë pjesëmarrëse të gjitha subjektet politike.

Jam për atë që të hiqen këto profesione, por të përcaktohet formula për caktimin e anëtarëve nga partitë politike. Kur të caktohet formula e përcaktimit të subjekteve politike, kryesuesja duhet t' i drejtohet me një shkresë partive politike dhe t' i specifikohen profesionet. Këtë propozim që e kemi nuk është adekuat, sepse ka profesione të cilat janë të parëndësishëm për këto pozita. Propozimi im është që këta emra duhet hequr dhe në të ardhmen mos të tentohet për të na sjell para aktit të kryer. Ne duhet të merremi vesh që ta formojmë një komision, ta caktojmë numrin prej sa anëtarëve dhe formula caktohet sipas përfaqësimit në Kuvend.

Valentinë Bunjkau- Rexhepi – propozimin të cilin e bëri, z. Arben Mehmeti është propozim edhe i grupit të LDK-së, të cilin propozim ka qenë e paraparë ta jap unë ose shefi i grupit. Paraprakisht ne kemi propozuar që 15 anëtarë të jenë në këtë Komision dhe atë në bazë të përfaqësimit të partive politike në KK.

Pra ky komision të jetë prej 15 anëtarëve, kurse menjëherë do t' i drejtohem partive politike që ta na i sjellin emrat, kurse Urbanizmi do ta sjell një emër dhe një anëtar nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Sahit Abazi- PDK në parim e përkrah këtë pikë të rendit të punës dhe ideja është që pavarësisht që është punuar në këtë drejtim nga komisioni paraprak, por tash kanë ndryshuar rrethanat, sepse është rrit qyteti. Ne e përkrahim në parim këtë propozim kështu siç është propozuar në Kuvend. Ne mundemi sot, mundemi nesër t' i dërgojmë emrat nga partia dhe do të mundohemi që të sjellim emra adekuat për këtë komision.

Jonuz Hasani- sa i përket këtij propozim- vendimi për plotësim të komisionit për emërtim të rrugëve, dëshiroj ta di se a do të përfshihen edhe fshatrat e afërme të Komunës së Gjilanit dhe çka do të ndodh me fshatrat të cilat janë të boshatisura?

Nevzad Isufi- ne jemi pajtuar në parim edhe në KPF për ta bërë një zgjidhje, por nuk jemi unik sa i përket përfaqësimit me vetë faktin se janë futur profesionistët për të cilin besoj se gjejnë pajtim pavarësisht grupimit politik. Mirëpo në pjesë të fundit mund të propozojmë përfaqësues politik, por në pjesën tjetër besoj se pajtoheni se mund të jenë profesionistë të cilët nuk i përkasin asnjë subjekti politik dhe që do të thotë janë bazuar në profesion me integritet të lartë. Edhe unë pajtohem që në të ardhmen të na sillat

propozim-vendimi dhe jo vendimi, sepse vendimet bëhen të plotfuqishme pasi që t' i aprovon Kuvendi. Gjithashtu pajtohem që të rritet numri i anëtarëve të Komisionit të cilin propozim e kam dhënë edhe në KPF, sepse është një propozim i mirë që të jetë në këtë komision edhe inxhinieri i komunikacionit ashtu si është propozuar, sepse lehtësohet puna dhe do të jetë një vendim më profesional.

Ibish Ibishi- unë plotësisht pajtohem me parafolësit e mi që në këtë komision të përfshihen të gjitha partitë dhe profilet të cilat u cekën, por duke e shtuar edhe ndonjë emër sipas nevojës. Unë kam pyetje për ata të cilët e kanë paraparë një plotësim të tillë dhe ajo është se a janë të përfshira edhe fshatrat në këtë projekt, sepse në propozim-vendim thuhet në tërë territorin e Komunës së Gjilanit a janë përfshirë fshatrat në këtë proces, apo është paraparë vetëm qyteti? Nëse përfshihet me ligj sistemi i adresave, do të ishte mirë që mos të anashkalohen edhe fshatrat dhe duhet të përfshihet në një pasues se si do të bëhet emërtimi i rrugëve në fshatra. Nëpër fshatra ka pasur iniciativa për t' u bërë emërtimi i rrugëve dhe arsyet janë të ndryshme, prandaj propozoj që në këtë projekt të përfshihen edhe fshatrat.

Ismet Hajdini- unë mendoj se në fillim ka qenë desh t' i japim fjalën zyrtarit nga Urbanizmi, sepse po bëhen pyetje e të cilat ndoshta ai me kohë do t' i kishte sqaruar. Më mirë do të ishte zyrtari të na jep sqarime, pastaj do të ketë pyetje dhe mos të humbim shumë kohë.

Bujar Nevzadi- ne e kemi biseduar edhe në KPF këtë çështje, por propozimi i juaj për ta rrit numrin në 15 anëtarë, unë e kam një rezervë se sa do të jetë funksional ky komision. Unë kam pasur fatin që të jem në atë komisionin e parë ku kemi qenë 9 anëtarë dhe ka pasur shumë probleme për të qenë unik 9 anëtarë, sepse në këtë rast duhet të ketë koncenues. Unë nuk jam për t' u rrit numri i anëtarë për arsye të koncenuesit dhe dy për shkak të dietës buxhetore, sepse ky komision duhet të kompensohet.

Valon Shefkiu- fillimisht po iu njoftoj se Komuna e Gjilanit e ka filluar projektin e digjitalizimit të adresave, konformë ligjit të sistemit të adresave. Koha e fillimit të projektit ka qenë qershori i vitit 2012 dhe në fillim është bërë pranimi i zyrtarëve dhe stafit mbështetës dhe nga ana e ish kryetarit të Komunës dhe me vendim është caktuar Fehmi Agushi si koordinator komunal në bashkëpunim me Agjensionin Kadastral të Kosovës. Këtë projekt e ka lanësaur KE për mbështetje të regjistrimit civil dhe sistemit të unifikuar të adresave. Ky projekt financohet nga BE dhe Qeveria Norvegjeze.

Drejtorja e Urbanizmit është përgjegjëse për këtë projekt dhe nuk është rastësisht Fehmi Agushi koordinator i këtij projekti- ky është një projekt i cili ka zgjat dy vite, por me çdo kusht duhet ta përfundojmë, sepse është nevojë e Komunës.

Unë po përpiqem të përgjigjem në disa pyetje dhe po filloj nga përfaqësuesja e LDK-së e cila kërkoi që disa rrugë të emërtohen me emra të qyteteve si rruga e Tiranës etj.

Sistemi i adresave i pranohet edhe këto rekomandime, por jo e Tiranës, por quhet rruga "Tirana". Inxhinieri i komunikacionit e sqarua se është pjesë e këtij komisioni.

Zonja Hyseni pyeti për kompletim të materialit, mirëpo komisioni i cili formohet ai pajiset me komplet materialin, me ligjin, udhëzimet administrative dhe doracakun për sistemin e adresave. Aty i kemi të gjitha kriteret se si emërtohet një rrugë, një shesh, një lagje etj.

U tha se Kuvendit gjendet para një akti të kryer të cilin vlerësim e tha Arben Mehmeti, por besoj se kjo nuk ka ndodhur, sepse ne nuk iu detyrojmë asgjë juve dhe këto janë

vetëm rekomandime. Ne ju rekomandojmë për të pasur ekip profesional, kurse stafin politik ju e zgjidhni vetë.

Fshatrat duhet të përfshihen patjetër në këtë projekt, sepse ky projekt përfshin tërë territorin e Komunës së Gjilanit në të cilat janë të evidentuara mbi 940 rrugë e të cilat duhet emërtuar. Në të njëjtën kohë janë të evidentuara 28 mijë hyrje e të cilat me siguri nuk janë të gjitha? Kur është fjala te fshatrat, komuniteti mund ta bëjë propozimin, kurse komisioni duhet t' i përfill sipas ligjeve të cilat i ceka më lartë.

Në vijim të fjalës së tij z. Agushi i sqaroi edhe fazat e zbatimit të këtij projekti.

Zijadin Malqi- ishte një propozim që komisioni të jetë prej 15 anëtarëve, pastaj emërimet të bëhen sipas çelësit politik. Kush është për këtë propozim?

Aprovohet pika 2.2. e rendit të punës: Propozim vendimi për emërimin e Komisionit për plotësimin e emërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Gjilanit, me 30 vota të anëtarëve të Kuvendit, nuk pati kundër as abstenime.

2.3 Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP “Ecohigjiena” në Gjilan

Bajram Hasani- ne e dimë se “Ecohigjiena” ka kaluar në statusin e PPP-së, ku ndërmarrja private i posedon 51% të aksioneve, kurse Komuna 49%. Mirëpo pas emërimit, nuk e kam të qartë se cili është roli i aksionarëve tanë gjegjësisht të Komunës? A kemi pasur ne anëtarë edhe në qeverisjen tjetër dhe a ka ndonjë raport për punën e Ecohigjienës? Në vendim shihet se obligim kanë këta aksionarë që t' i raportojnë Kuvendit çdo vit, mirëpo unë kërkoj sqarime se cili do të jetë roli tyre në këtë ndërmarrje të aksionarëve të Komunës dhe a ka pasur raport nga ky komision në qeverisjen tjetër?

Nevzad Rushiti- unë pajtohem me konstatimin e Bajramit, sepse në qeverisjen e kaluar ky komision i aksionarëve nuk ka raportuar! Mirëpo nëse ky komision emërohet sot duhet të jetë e qartë se ky komision e ka për obligim për t' i raportuar Kuvendit.

Duhet pasur kujdes se këto janë dy kompani të cilat duhet t' i raportojnë KK-së, sepse i obligon ligji për t' i raportuar Kuvendit. Gjithashtu edhe Kuvendi dot ë jetë i kujdesshëm dhe do të propozoj njerëz kompetent të cilët do të japin kontribut në këto kompani!

Nevzad Isufi- në këtë rast ne kemi pasur paqartësi dhe në radhë të parë për mënyrën e shkarkimit të atij Komisioni, por nëse tash duhet të zgjidhet komisioni i ri shtrohet pyetje pse zgjidhen vetëm dy anëtarë? Çfarë përfaqësimi është ky me dy anëtarë?

Sahit Abazi- pyetje për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik: në këtë komision ka qenë edhe një përfaqësues i PDK-së dhe një i LDK-së? Shkarkimi i tyre dhe emërimi i një komisioni të ri nënkupton se vetë LDK është e pakënaqur me anëtarin të cilin e ka pasur në këtë Komision, por kërkoj përgjigje se a i ka kërkuar llogari anëtarit të vetë në këtë komision?

Isa Agushi – unë nuk e kam të qartë se a është bërë ndonjëherë ndonjë analizë, kur një pronë komunale private i posedon 51%, kurse Komuna 49%. Këtë nuk e kam parë as dëgjuar askund! E dyta kompania private me 51% a i ka plotësuar kriteret e investimeve dhe a ka bërë ndokush ndonjë analizë dhe a ka bërë ndonjë raport në Kuvend? Kërkesa ime është që ta rishikojmë atë 51% dhe të shikohet se a ka bërë investimet të cilat i ka pasur sipas kontratës?

Shpresa Kurteshi- përkitazi me këtë komision, drejtori mund të na i heq disa dilema dhe mund t' i kemi disa gjëra më të qarta. Gjithashtu vërejtje kam se në këtë propozim për anëtarë të komisionit nuk ka emra? Mirëpo ne kur të votojmë një komision duhet të jenë emrat e propozuar dhe duhet ta dimë se kë po e votojmë dhe kush po e përfaqëson këtë kompani në këto komisione ?

Ibish Ibishi – sa i përket komisionit në qeverisjen e kaluar i cili ka qenë i formuar dhe i cili kurrë nuk i ka raportuar këtij Kuvendi, ai është faj i atij komisioni të cilët kanë qenë në atë komision dhe nuk është faj i Kuvendit. Për obligim po thuhet se ai komision duhet të raportojë në bazë vjetore, por nuk e kam të qartë cila është ajo bazë vjetore, katërvjeçare, njëvjeçare, apo si është paraparë? Unë mendoj se ky komision nëse mendojmë se duhet të punojë, atëherë duhet ta kushtëzojmë që të raportojë në çdo tre muaj! Në këtë kompani bëhen shumë parregullsi, kurse ky Kuvend nuk ka asnjë njohuri, prandaj ky komision duhet të obligohet që të raportojë çdo tre muaj.

Valentinë bunjaku- Rexhepi- në komision duhet të jenë dy anëtarë atë e përcakton ligji, kurse sa i përket raportit edhe kjo është përcaktuar me ligj dhe së paku njëherë në vit duhet të raportojnë.

Riad Rashiti- do të ishte mirë që me kohë t' i kishim emrat e të propozuarve dhe ju e thatë që KK i ka emrat. Është mirë që emrat të prezantohen, emrat, të cilët janë ata persona. Në mandatin e kaluar ky komision e ka pasur një anëtarë të PDK-së dhe një të LDK-së. Unë në emër të grupit të PDK-së kërkoj që ta kemi një anëtarë tonin në këtë komision.

Bajram Hasani- unë nuk pajtohem me Riadin, kur thotë se ne nuk mund t' i japim instruksione komisionit, sepse nëse ne jemi organi që i emërojmë dhe ata duhet t' i raportojnë Kuvendit. Sa i përket ligjit ata duhet t' i dinë obligimet e veta dhe duhet ta respektojnë.

Ismail Jonuzi- në seancën e kaluar një vendim për shkarkim të këtij komisioni është marrë dhe si arsyetim ka qenë mungesa e raportimit në KK. Komisioni nga aspekti profesional duhet të jetë në nivel, por dhe llogaridhënia. Ecohigjiena është me dy anëtarë të Këshillit, kurse ndërmarrja tjetër Kosovatrasi i ka tre anëtarë. Ligji i përcakton edhe llogaridhënien edhe mënyrën e raportimit. Raportimi duhet të bëhet çdo tre muaj, kurse në fund edhe raporti vjetor. Unë mendoj se këto Këshilla duhet të jenë profesionale dhe nuk kanë të bëjnë me përfaqësim politikë. Në mungesë të profesionalizmit ka ardhur deri te shkarkimi i Komisionit, prandaj unë iu lus mos ta politizoni komisionin, sepse këtu duhet të kërkohet llogaridhënia dhe kur është fjala për këto komisione në këto ndërmarrje, duhet të jenë profesionale dhe jo politike. Unë mund të propozoj dhe propozimi është me emra profesional e të cilët do të japin llogari para juve. Unë për Ecohigjienë do t' i propozojë dy emra e të cilët mund të japin kontribut dhe këta dy emra janë; Xhelal Jetishi dhe Muhadin Haziri. Këta dy emra propozohen si profesionist dhe jo nga ana politike, prandaj kërkoj nga ju që t' i aprovoni këta dy emra.

Riad Rashiti- atë që e tha drejtori për Zhvillim Ekonomik e tha mirë, sepse në këtë Këshill duhet të jenë njerëz profesional, mirëpo kur doli propozimi na nxiti që të reagojmë, sepse emrat e të propozuarve aspak nuk janë profesional? Njëri prej tyre ka

qenë i punësuar në këtë kompani dhe ende është në procedurë gjyqësore për një rast të cilin e dinë shumë mirë drejtori. Tjetra ne kërkuam që të kemi përfaqësim në këtë komision, sepse edhe propozimin e tretë e ka kryetari i Komunës dhe të shkojnë tre kuadro në këtë Komision është e papranueshme. Gjithashtu ne si Kuvend duhet t' i bëjmë dy propozime dhe jo drejtori për Zhvillim Ekonomik të jap propozime këtu. Sa na përket neve këta emra nuk janë të pranueshëm për këtë komision!

Valentinë Bunjkau- Rexhepi – ka të drejtë z. Riadi, sepse drejtori nuk është këtu për të propozuar emra, por edhe unë i kam të njëjtët emra të cilët emra i kemi propozuar në grupet tona kuvendare.

Bujar Nevzadi- unë kërkoj nga drejtori për Zhvillim Ekonomik që ta tërheq fjalën që e tha se këta njerëz janë profesional dhe nuk janë politikë! Këta dy njerëz komplet janë aktivistë të LDK-së dhe nuk i bën nder ky propozim drejtorit dhe mos të thotë se nuk janë politikë!

Riad Rashti- kryesuesja ka pasur mundësi të diskutojë me grupin e këshilltarëve të LDK-së jashtë seancës. Mirëpo në seancë iu takon juve si grup kuvendar t' i propozoni emrat zyrtarisht në këtë seancë. Unë mund të jem gabim dhe nëse gaboja kërkoj falje publike, por me sa di unë një ri nga të propozuarit e ka të kryer vetëm shkollën e mesme dhe të propozohen kandidatë në këtë komision me shkollë të mesme është shumë e papranueshme.

Bujar Nevzadi- nëse nuk përfillen kërkesat tona ne e kemi edhe formën tjetër të reagimit. Mund t' i thërrasim qytetarët që mos ta bëjnë pagesën e mbeturinave ! Ne kemi punuar gjatë dhe po vazhdojmë për të punuar, prandaj iu lus që propozimet e juaja t' i rishqyrtoni dhe të bëjmë propozime që e bashkojnë këtë Kuvend dhe jo që e ndajnë!

Nevzad Isufi- propozimi i emrave nuk qenka koincidençë në mes kryesuese dhe drejtorisë, prandaj është mirë që njerëzit që janë në konflikt të interesit të mos propozohen, mandej të na epet një CV e këtyre njerëzve dhe ta marrin përgjegjësinë ata që bëjnë propozime në këto komisione.

Selami Xhemajli- në seancën e kaluar kur është marrë vendim për anulim të anëtarëve të këtij komisioni, ne e kemi përkrah me qëndrimin që të kemi përfaqësim në këto dy komisione të Aksionarëve si pjesë e koalicionit. Edhe sot kërkoj që si pjesë e koalicionit të kemi përfaqësim në dy komisionet si në Ecohigjienë ashtu edhe në Kosovatrans.

Pas fjalës së z. Xhemajli dhe propozim të tij, kryesuesja i liron anëtarët e Kuvendit në një pushim prej 10 minutave.

Pas pushimit, seanca i fillon punimet dhe vazhdon debati për pikën 2.3

Bajram Hasani- duhet t' i dallojmë aksionarët dhe këta dy përfaqësues që e përfaqësojnë Komunën, kurse kur të formohet Bordi (Këshilli), duhet të jenë njerëz profesionist, sepse ata e menaxhojnë ndërmarrjen, kurse këta aksionar janë vetëm përfaqësues të Komunës.

Fehmi Sylejmnai- unë mendoj se nga dy propozime, mendoj se njëri duhet të jetë nga opozita! Personin në numrin 1 i cili ishte Xhelal Jetishi është propozim me të cilin pajtohem, por anëtarin e dytë të na e jepni mundësinë që ne opozita ta propozojmë!

Riad Rashti- unë e kam vetëm një pyetje. A i takon opozitës me ligj një vend në këtë komision? Unë mendoj që po! Mandej të na njoftoj drejtori për kandidatin numër 2 se ku ka punuar, sa ka përvojë pune, për çfarë arsyeje i ka dy raste në gjykatë dhe a e dini që është konflikt interesi apo nuk e dini? Pyetja tjetër është për kryesuesin a i takon në bazë të përfaqësimit politik opozitës një vend? Mandej në këtë kompani janë të përfshira tri komuna, por aktualisht janë dy Gjilani dhe Vitia. Kërkoj nga Zyra Ligjore që të na ep sqarime se a duhet të jetë një anëtar nga Vitia në këtë komision?

Isa Agushi.- unë deklaroj se Muhadin Haziri është personi më profesional se të gjithë të tjerët i cili ka punuar një kohë të gjatë në Ecohigjienë dhe janë bërë shumë padrejtësi ndaj tij. Muhadin Haziri nuk është vetëm meshollë të mesme, por është ekonomist i diplomuar dhe është njeri i cili e njeh këtë lëmi dhe është një ndër më të preferuarit për këtë komision. Gjithashtu ka pasur padi në gjykatë, por që të gjitha i ka fituar dhe prapë do t' i fitojë. Ky është personi më kompetent, por janë bërë shumë padrejtësi ndaj tij.

Riad Rashiti- z. Agushi pati qasje personale, por Muhadin Haziri është larguar nga kompania Ecohigjiena, sepse nuk ka desh ta respektojë një marrëveshje për PPP të lidhur në mes të Komunës dhe një partneri privat. Atë marrëveshje e kanë votuar të gjithë kolegët e juaj këtu, por personi në fjalë me muaj të tërë ka sjell probleme dhe e ka penguar zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Ai për këtë arsyeje është larguar nga Bordi dhe e ka paditur kompaninë në gjykatë dhe gjykata nuk i ka dhënë të drejtë dhe e ka anuluar ankesën e Muhadin Hazirit. Përsëri i përmenduri ka bërë ankesë në Gjykatën Supreme, por edhe kjo gjykata ia ka anuluar të drejtën e ankesës dhe e ka shpall kompetente Gjykatën Komunale për këtë çështje. Ai është larguar nga kompania dhe nuk ka arsyeje që ai të propozohet në këtë komision!

E dyta ai e ka edhe një rast të vjetër në gjykatë me Higjienën e cila ende nuk është zgjidh, prandaj përderisa është konflikt interesi nuk duhet të jetë ky person në këtë komision. Ne e kemi propozimin tonë dhe të cilin duhet ta propozoni në Kuvend dhe Kuvendi të merr vendim për këtë.

Hevzi Matoshi-nëse i referohemi paragrafit 5.2 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike aty shumë qartë thuhet se KK i propozon dhe i zgjedh dy anëtarë në komisionet për ndërmarrjet publike, për pjesën e aksioneve të cilat i posedon Komuna.

Sahit Abazi- sa i përket interpretimit nuk ka ndonjë interpretim të saktë, por është një traditë në këtë Kuvend se në këto komisione gjithmonë është propozuar dhe aprovuar një anëtarë nga pozita dhe një nga opozita. Nëse ka një tendencë për ta thyer këtë traditë është çështje e pushtetit, por ne e kemi një propozim adekuat për këtë rast dhe ky propozim është për Nuhi Nuhiun i cili është ekonomist i njohur në Gjilan i cili ka qenë edhe drejtor i Financave. Ne e propozojmë Nuhi Nuhiun dhe kërkojmë që votimi të bëhet në pako me propozimin e parë

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- propozimi i ynë është Xhelal Jetishi dhe Muhadin Haziri, kurse propozimi i opozitës është Xhelal Jetishi dhe Nuhi Nuhiu.

Riad Rashiti- unë kam pyetje për drejtorin se a është i njoftuar se Muhadin Haziri ka padi në Gjykatë?

Ismail Jonuzi- unë nuk merrem me atë se kush ka lëndë në gjykatë, por unë e di se Muhadin Haziri është punëtor i Ecohigjiensë dhe është një ekonomist i diplomuar dhe ne e kemi propozuar si profesionist për këtë punë.
Përderisa dikush nuk është i dënuar ne nuk mund t' i paragjykojmë vendimet e gjykatës.

Sahit Abazi- e para propozimi i parë është jo ligjor, sepse është dhënë nga drejtori për Zhvillim Ekonomik, sepse drejtori është ekzekutiv dhe ky propozim duhet të tërhiqet dhe për atë se ky propozim nuk është ligjor ne kërkojmë që i pari të votohet propozimi i ynë, kurse i dyti të jetë propozimi juaj.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- kërkoj nga drejtori për Zhvillim Ekonomik që ta tërheq propozimin, sepse propozimi duhet të vijë nga anëtarët e Kuvendit.

Ismail Jonuzi- unë kërkoj falje, sepse ndoshta nuk i kam njohur procedurat e Kuvendit, por unë kam menduar nga aspekti i përgjegjësisë dhe kërkoj falje dhe e tërheq propozimin.

Isa Agushi- unë për këtë komision i propozoj Xhelal Jetishin dhe Muhadin Hazirin.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi – ne po propozojmë që së pari Kuvendi të deklarohet për propozimin e opozitës dhe së pari të votohet Xhelal Jetishi dhe Nuhi Nuhiu dhe ju lutem deklarohuni se kush është për këtë propozim?

Kuvendi për propozim të Xhelal Jetishit dhe Nuhi Nuhiut ishte; për 11 vota, kurse 12 kundër dhe ky propozim nuk aprohet.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- të deklaroheni se kush është për propozim të Xhelal Jetishit dhe Muhadin Hazirit?

Kuvendi votoi në këtë mënyrë: 13 ishin për, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit, as për, as kundër, por edhe as abstenime dhe ky propozim aprohet.

Besë Baftiu- më intereson për ta ditur se ky vendim i cili u aprovua a është me 2/3 apo me shumicë të thjeshtë?

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- ky votim është me shumicë të thjeshtë, ashtu si e kërkon ligji

Bujar Nevzadi- unë kërkoj që të numërohen sa anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm në sallë, sa kanë votuar për dhe sa kundër, sepse sipas meje nuk kanë votuar 51%.

Sekretari konstatoi se në sallë ishin 30 anëtarë të Kuvendit.

Bujar Nevzadi- të shënohet në procesverbal se nga 30 anëtarë të Kuvendit sa ishin të pranishëm në punimet se seancës e të cilët morën pjesë në votim, 13 kanë votuar për propozimin e pozitës!

2.4 Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të

Aksionarëve në Ndërmarrjen për transportin e udhëtarëve “Kosovatrans” në Gjilan

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – po e hapim debatin përkitazi me këtë pikë për t' i propozuar anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve për ndërmarrjen publike

“Kosovatrans”. E njëjta formulë është edhe për këtë ndërmarrje dhe grupi i LDK-së e propozon z. Abdyl Jerliun dhe Mukadeze Rexhepin.

Fehmi Sylejmani- ne edhe për këtë rast e kemi të njëjtin qëndrim dhe kërkojmë që një anëtar të jetë nga opozita dhe unë e propozoj Leonard Miftarin i cili me profesion është ekonomist i diplomuar.

Ismet Hajdini- të na e jepni zonja kryesuese një biografi për këta njerëz, sepse ne nuk po e dimë se kush janë?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- Abdyl Jerliu është mr. i Ekonomisë dhe i ka dy fakultete paralelisht të përfunduara edhe Fakultetin Juridik dhe atë Ekonomik, kurse magjistraturën e ka në ekonomi, kurse Mukadeze Rexhepi është magjistre e ekonomisë.

Ju lutem të deklaroheni se kush është që në këtë komision të jetë: Abdyl Jerliu dhe Mukadeze Rexhepi?

Kuvendi e aprovon propozimin e zonjës kryesuese që anëtarë të Komisionit në Kosovatrans të jenë Abdyl Jerliu dhe Mukadeze Rexhepi me 17 vota për, kurse 10 ishin kundër.

3. Propozim vendimi për lejimin e transferit të mjeteve të mjeteve financiare nga planifikimi i të hyrave vetanake.

Sali Kçiku- me kërkesën e kryetarit është bërë një transfer te kodi i kryetarit 160, Zyra e Kryetarit si dhe kodi ekonomik 627 për subvencione në vlerë prej 100 mijë €. Këto janë mjete buxhetore, por kërkojmë që të bëhet një transfer te kodi i kryetarit.

Ismet Hajdini- këso transfere ka pasur edhe në pushtetin e kaluar shumë herë dhe kjo është në interes të Komunës dhe të drejtorive përkatëse dhe jam i mendimit se duhet ta përkrahim të gjithë këtë transfer.

Riad Rashiti- sa i përket propozim-vendimit për transfer të mjeteve kërkoj që ta di se në bazë të cilit nen bëhet ky transfer, kurse sa i përket zhvillimit dhe disponimit është krejt në rregull edhe pse në vendim nuk është theksuar e tëra ajo që duhet të theksohet, sepse u pa se ka edhe destinime tjera të shfrytëzimit të kësaj shume prej 100 mijë €.

Mirëpo ne mendojmë se këtij vendimi ka qenë desh t’ i paraprijnë edhe disa procedura të tjera dhe do të duhej që t’ i bashkëngjitej edhe një material shtesë për këtë çështje, sepse paraprakisht do të duhej që të paraqitet para Kuvendit kërkesa për një destinim të tillë.

Ne asnjë kërkesë nuk e kemi pasur, por na ka ardhur një vendim për këto mjete për një destinim e cila do të duhej të kalonte në KK, një kërkesë për ndërtimin e shtëpive për familjet e pastrehuara. Mendoj se procedura nuk është zbatuar ashtu si duhet, sepse nuk e kemi as të vetmin informacion shtesë se për cilat familje do të destinohen këto mjete?

Thuhet se janë 100 mijë €, por ndahen subvencion te Zyra e Kryetarit për pa e ditur se cilat mjete po destinohen? Unë e di që ekziston një Komision në Zyrën e Kryetarit i cili është marrë me këtë çështje në Komunë të Gjilanit. Në këtë Komision është edhe Sadri Arifi, shef i Shërbimit të Kuvendit i cili e dinë saktë gjendjen e familjeve të tilla, e kanë listën e familjeve dhe do të duhej që vendimit t’ i bashkëngjitet edhe lista e familjeve me prioritet të cilat kanë nevojë që t’ i ndërtohen shtëpitë e tyre ose të bëhet strehimi i tyre. Gjithashtu nuk është planifikuar se ku mendon Komuna e Gjilanit për t’ i ndërtuar

këto shtëpi? A janë pronat e tyre, apo është planifikuar që Komuna t'ia ndajë hapësirën për ndërtimin e këtyre shtëpive dhe nëse po, në cilin lokacion? A ka vendimin për lejimin e shfrytëzimit të asaj toke etj? Mirëpo siç po shihet për të dy çështjet asnjë informacion nuk e kemi dhe asnjë procedurë nuk është kryer!

Selvete Shurdhani- transferi është i lejuar dhe është kërkesë e kryetarit, por sa po e shoh unë në sektorin e shëndetësisë është një shifër shumë e vogël dhe me këtë shifër nuk e kam të qartë se çka mund të llogarisim dhe çka mund të planifikojmë me këtë shifër kaq të vogël? Edhe në sektorin e bujqësisë dhe të shëndetësisë janë dy shifra të vogla sa që ndoshta nuk do të kishte pasur nevojë të hyjnë fare në këtë transfer. Këto janë shumë shifra të vogla.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi – ne jemi te pika 3 e rendit të punës, kurse për pikën 4 ende nuk është hapur debati.

Fatbardhë Selmani- kërkoj një sqarim përkitazi me transferin apo dhënien e subvencioneve për Shoqatën e Hendikosit, Shurdhmemecëve dhe të Verbërve, sepse me sqarimin e kryetarit u kuptua se një shumë e mjeteve do të ndahet për këto shoqata. Mirëpo kam pyetje se a do të përfshihet edhe propozimi i ynë që ishte për një shumë mbi 28 mijë €, të cilat i ka kërkuar Hendikosi dhe një shumë e caktuar për shoqatat e tjera? Kërkoj sqarim për këtë çështje?

Shukrie Rapuca- me këtë vendim është paraparë përveç të tjerash të merren mjete edhe nga Drejtoria e Bujqësisë (2.700.00 €). Mendoj se kësaj drejtorie duhet për t' i dhënë më tepër mjete, por bile së paku mos t' i merren ato pak financa që i posedon. Si duket i kemi harruar premtimet që i keni dhënë gjatë fushatës se do të ndani çdo vit nga 1.5 milion € subvencione në bujqësi.

Sali Kçiku- transferi i këtyre mjeteve bëhet për t' i ndihmuar familjet skamnore për strehimin e tyre. Kjo është një kërkesë në Kuvend për të kaluar një vendim dhe pasi të kalojë vendimi, ne duhet të bëjmë kërkesë në MEF dhe atje duhet të aprovohet. Sa i përket komisioneve për skamnorë, pasi të zotohen dhe ndahen mjetet, atëherë mund t' ia fillojmë punës. Nuk mund ne t' i fillojmë punës, t' i premtojmë njerëzve për pa pasur mjete! Pasi të aprovohet nga Ministria e Financave, atëherë formohet komisioni dhe fillon puna.

Riad Rashiti- nuk po më duket aspak në rregull përgjigja e drejtorit të Financave, sepse së pari është jo procedurale dhe jo logjike! Nuk është logjike të kërkojnë mjetet për pa ditur për çfarë arsyeje po i kërkon mjetet? Duhet të dihet destinimi i mjeteve që po i kërkon? Së pari do të duhej të ishte lista e familjeve për të cilat është kërkuar sot të ndahen mjete dhe të bëhet transferi prej një kodi në kodin tjetër. Nuk është në rregull që të kërkojmë para dhe mandej të shohim se çka do të bëjmë? Ne jemi Kuvend dhe duhet të marrim vendime me prioritet. Ne këtu nuk kemi prioritet dhe nuk po e dimë se për çka po kërkojmë transfer dhe kjo për mua nuk është në rregull.

Zijadin Maliqi- sot është fjala për transfer të mjeteve në këto programe (te Zyra e Kryetarit), për subvencione. Ne e kemi edhe Rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe aty është një kufizim se sa mjete mund t' i ndajë vetë kryetari (1.200) €. Mbi 1 mijë e 200 €, vendos Kuvendi. Mirëpo për çdo investim, familje, ndarje të subvencioneve

për qëllime të caktuara, prapë duhet të vijë në Kuvend për aprovim. Kjo është vetëm transfer i Ministrisë së Financave për t' u bartë mjetet te kryetari për subvencione. Mirëpo për vendime të mëtejme përsëri vendos Kuvendi.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja kërkon që të aprovohet pika .3 e rendit të punës.

Aprovohet pika tre (3) e rendit të punës: Propozim vendimi për lejimin e transferit të mjeteve të mjeteve financiare nga planifikimi i të hyrave vetanake, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

4. Propozim-vendimi, për lejimin e transferit të mjeteve financiare në shëndetësi

Sali Kçiku- ky transfer kërkohet të bëhet nga kode të tjera në kodin e shëndetësisë me qëllim që të bëhet furnizimi me pajisje mjekësore në QKMF. Këtu është një pjesë shtesë prej mbi 36 mijë €.

Besë Baftiu- edhe ne si grup i LVV e përkrahim këtë transfer, sepse e dimë se shëndetësia është në një gjendje shumë të rëndë dhe sidomos është mungesë e barnave esenciale dhe gjithçka që është për të mirë të qytetarëve ne e përkrahim.

Fatbardhë Selmani- kërkojmë informatë se çka po tërhiqet prej projekteve në investimet kapitale dhe në anën tjetër ku konkretisht do të shfrytëzohen këto mjete në shëndetësi? Ne në mbledhje të Komitetit të Shëndetësisë nuk jemi informuar asnjëherë që ka ndonjë çështje emergjente? Po ashtu kërkoj sqarim se cilat projekte do të mbesin për pa u zbatuar te mirëmbajtja e projekteve shëndetësore, sepse me këtë vendim po tërhiqen mbi 26 mijë €. Pyetje tjetër është se cilat pajisje shëndetësore nuk do të blihen për shkak të tërheqjes së këtyre mjeteve në vlerë prej 9mijë .960 €?

Valentinë Bunjaku – Rexhepi- në përgjigjen e juaj do të përgjigjet drejtorja e shëndetësisë e cila aktualisht nuk është e pranishme në seancë.

Sali Kçiku-kur është bërë projekti 90391, rekonstruimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore është minus 24.400. 00 €

Projekti 90392 pajisje shëndetësore minus 7.470.00€ dhe burimet financiare, te hyrat vetanake 4.980.00 €. Prej këtyre projekteve të cilat i keni në vendim kërkohet që të merren këto mjete dhe prapë të shkojnë në Drejtori të Shëndetësisë, por si prioritet iu ka dhënë këtyre gjërave dhe është bërë me kërkesë të kryetarit.

Riad Rashiti- ne kërkuam sqarime, kurse drejtori po i lexon ato që i kemi në vendim dhe nuk ka nevojë të lexohen ato, por kërkojmë sqarim për atë që e tha zonja Selmani?

Edhe pse nuk është drejtorja këtu, ka zyrtarë të tjerë këtu dhe mund të epet përgjigje.

Sa i përket kodit për pajisje shëndetësore, por dhe buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi ka qenë i paraparë se çka do të investohet me këtë fond të mjeteve në vitin 2014.

Një buxhet planifikohet për ta ditur se si do të shpenzohet, prandaj ne dëshirojmë për ta ditur se çka është shpenzuar nga ky kod dhe cili projekt ka mbetur mangu si shkaktar i këtij transferi?

Sali Kçiku- unë e sqarova se cilit kod i kemi marrë këto mjete si dhe prioritet e shëndetësisë dhe prioritete e kësaj drejtorie.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 4 e rendit të punës?

Aprovohet pika 4 e rendit të punës: Propozim-vendimi, për lejimin e transferit të mjeteve financiare në shëndetësi, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit., kurse të tjerët abstenuan.

5. Të ndryshme

Valentinë Bunjaku –Rexhepi – në pikën nën të ndryshme po e hapim debatin dhe po i japim fjalën anëtarëve të Kuvendit , kurse pyetjet e juaja ose reagimet do t’ ia dërgojmë drejtorive përkatëse e të cilat do t’ iu përgjigjen me shkrim. Pas fjalës drejtorit keni mundësi për replikë dhe pastaj mbyllet debati.

Sahit Abazi- në një seancë të kaluar e ngrita çështjen e 6 zyrtarëve të cilët janë pranuar në Shërbimin Civil të Komunës i cili fakt është shqetësues për neve. Nga këta 6 zyrtarë 4 janë përmendur me emër dhe mbiemër nga ana e jonë në dy seanca të më parme dhe bëhet fjalë për Brahim Ademin në Zyre të Prokurimit, Burim Elezi, në Zyrën për Integrime Evropiane, Hazir Mustafa në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Kushtrim Kadriu në Bibliotekë. Ne këta emra i kemi përmendur para konkursit të cilin fakt e vërteton procesverbali dhe nuk ka qenë e vështirë për t’ i ditur, sepse të gjithë këta njerëz janë zyrtar ose drejtues të LDK-së. Të gjithë këta njerëz pothuaj se është ditur se do të punësohen, kurse gjatë tërë fushatës elektorale, kryetari ka thënë që nuk do ta politizojmë Administratën Komunale. Unë nuk kam asgjë personale, por edhe kur tentoni t’ i punësoni anëtarët e juaj të partisë bëni përzgjedhjen e më të mirëve dhe jo vetëm atë pjesën klienteliste të politikës.

Gjithashtu në një seancë unë i kam bërë një pyetje kryetarit se çka do të ndodh me emrat e disa fëmijëve të Dëshmorëve të cilët kanë qenë të punësuar në Komunë. Është rasti konkret me Kosovare Ademin e cila është e bija e Dëshmorit dhe e cila ka konkurruar në tri vende të punës dhe në dy raste nuk është ftuar fare në intervistë, kurse përgjigja e kryetarit ka qenë më tregoni si ta bëjmë një zgjidhje për këtë njerëz, sepse unë jam i gatshëm për t’ i punësuar!. Kryetari qeverisjen e kaluar e pat quajtur qeverisje aziatike, por kjo e juaja tash është qeverisje sovjetike e viteve 90, kur presidenti Jelcin rregullat e demokracisë i kishte në letër, por nuk i zbatonte kurrë!

Keni thënë se nuk do të ketë pagesa me kontratë në vepër, por Hazir Mustafës iu është bërë pagesa në formë të tillë. Është një ligj për vullnetarizmin, por më duket as ky ligj nuk ia lejon askujt që të qëndrojnë te Zyra e Kryetarit siç është rasti me Arben Hazirin i cili është edhe familjar i kryetarit i cili nuk merr rrogë, por nuk dihet arsyeja pse qëndron aty? Gjithashtu është edhe një asistente ekzekutive të cilën nuk e di si e keni punësuar, por ajo është aty? Besoj se në seancën e radhës kryetari do të përgjigjet, sepse ka bashkëpunëtorë të cilat ia përcjellin këto pyetje dhe shqetësime tona!

Fehmi Sylejmani – së pari do ta ngris çështjen e plotësimit dhe ndryshimit të statutit të Komunës dhe ky Komision duhet ta plotësojë statutin me një nen ku mundësohet deklarimi jashtë rendit të punës dhe të jetë pyetje dhe përgjigje dhe të jenë të përshërshme. Pyetje konkrete kam për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit: podrumi te objekti për banim kolektiv afër Gjinnazit sipas informatave tona do të jetë 6 kate është në përfundim e sipër. Mirëpo duke pasur parasysh se objekti është në ndërtim e sipër ne kërkojmë për

ta ditur se investitori a është duke e respektuar lejen e ndërtimit të këtij objekti? Nëse po, atëherë me çfarë të drejte ju ia keni dhënë lejen për ndërtim gjashtë kate, kur dihet se afër shkollave nuk lejohen ndërtime të larta, por edhe nuk po respektohet 40% për gjelbërim.

Pyetje tjetër është për drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike: në Rrugën Kadri “Halimi” në Lagjen Dardania është dëmtuar puseta dhe për këtë janë bërë vizita zyrtare nga policia, zyrtar të ndërmarrjes “Hidromorava” dhe inspektori kompetent dhe deri më 26 korrik nuk është bërë riparimi ose rivendosja e pusetës e cila mund të jetë shkaktare e ndonjë aksidenti rrugor ose kalimtar të rastit.

Pyetja është pse nuk ka filluar asfaltimi i rrugës së shtatë në Lagjen “Dardania I”

Pyetja e radhës është për drejtorin e Arsimit e cila pyetje ka të bëjë përkitazi me testin e maturës në Gjilan, sepse është anuluar testi dhe pritet përsëritja e testit? A do të ndëshkohet dikush për keq menaxhim dhe në çfarë forme do të riorganizohet ripërsëritja e testit. Të njëjtën përgjigje e kërkoj edhe për konkursin për drejtorë të shkollave dhe anulimin e këtij konkurs?

Besë Baftiu- edhe ne jemi të indinjuar përkitazi me punësimin e disa punëtorëve në Shërbimin Civil Komunal me ç’ rast janë pranuar 6 punëtorë, por sipas informatave që i kemi kandidatët nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit! Pyetja e ime është se cilat janë arsyet e mos respektimit të ligjit në këtë rast?

Gjithashtu kryetari e ka thënë se do të kenë përkrahje fëmijët e dëshmorëve, por në këtë rast emri i Kosovare Ademit është rast specifik, sepse ka punuar një vit me kontratë në vepër që nuk është punësim i duhur, por përsëri kjo bijë Dëshmori ka qenë desh të ketë përparësi ndaj kandidatëve tjerë.

Si mund kryetari apo dikush tjetër të shkojë të përkulet para Varrezave të Dëshmorëve, kurse në anën tjetër fëmijët e tyre të mos kenë përkrahje?

Bajram Hasani-mua nuk po më pëlqen kjo që personalizohen gjërat dhe po flitet me emra. Ne jemi legjislativ dhe nuk jemi ekzekutiv dhe mund të kërkojmë raport të procedurave të prokurimit për pozita konkrete, por jo edhe të marrim kompetenca të ekzekutivit. Nuk duhet shndërruar Kuvendin në ekzekutiv.

Arijetë Rexhepi- unë kam një pyetje për drejtorin e Gjeodezisë Kadastrës dhe Pronës, sepse qytetarët po maltretohen shumë me shërbimet të cilat kryhen nga kjo drejtori.

Për punën të cilën duhet ta kryejë kjo drejtori, qytetarët duhet të shkojnë ta kryejnë në firma private. Pyetja është se kur do ta ndalni këtë praktikë jo të mirë dhe çfarë masa do të marrë drejtoria për këta zyrtarë?

Sadullah Kadriu – unë jam i brengosur me disa diskutues, sepse kuvendarët kur ta marrin fjalën duhet ta kenë parasysh se çka flasin dhe për kënd flasin? U përmend një emër nga z. Abazi një emër i cili është anëtar i “Vatrës” i cili plot tri vite ka punuar me kontratë në vepër, kurse tash është kthyer përsëri në vend të punës. Ai zyrtar është i biri i një atdhetari (Nijazi Kadriu) i cili ka pasur 38 vite veprimtari atdhetare dhe të thuhet pse është punësuar i biri i tij, vërtetë për mua është e pakuptimtë!

Jonuz Hasani- unë i kam dy shqetësime përkitazi me Lagjen “Arbëria” për rastin e firmës “Consoni” i cili rast është mjaft shqetësues dhe me këtë rast duhet të merret Drejtoria e Inspeksionit. Si problem tjetër është rruga e cila shkon në drejtim të Deponisë e cila rrugë në tërësi është e mbuluar me mbeturina. Gjithashtu kjo pjesë e qyteti në tërësi është

harruar nga qeverisja e kaluar për shkaqe partiake dhe elektrifikimi është bërë nëpër rrugë të aktivistëve. Në këtë pjesë asnjë investim nuk është bërë dhe qeverisja e kaluar asnjë trotuar nuk ka qenë në gjendje për ta përfunduar. Në këtë rrugë rreziku është shumë i madh, sepse nxënësit çdo ditë nëpër këtë rrugë shkojnë në shkollë!

Mevlyde Zejnullahu- në seancën e kaluar drejtori i Arsimit ka premtuar se do të jetë një seancë e veçantë ku do të debatohet vetëm për problemet e Arsimit në Komunën e Gjilanit. Situata në shkollat tona është mjaft e rëndë, sepse 70 punëtorë mbesin të papunë dhe shtrohet pyetja pse po ndodh kjo? Pyetja konkrete është a ekziston mundësa që të mos zvogëlohet numri i paraleleve të klasave të dhjeta? Madje duhet shqyrtuar mundësinë që në një klasë të ketë deri në 25 nxënës, sepse deri më tash kemi pasur paralele me 7 dhe 5 nxënës, por edhe me një nxënës në Shkollën e Muzikës!

Riad Rashiti- unë po ia rikujtoj kërkesën të cilën ia drejtova Zyrës Ligjore sa i përket të drejtës së kryetarit të Komunës për të ndërprerë kontrata me kompanitë e kontraktuara të cilat kanë qenë të lidhura në qeverisjen e kaluar? A ka të drejtë kryetari i Komunës që përmes një njoftimi të bëjë ndërprerjen e kontratave, sepse sipas informacioneve Zyra e Prokurimit nuk e ka filluar një procedurë të tillë dhe nuk ka bërë ndërprerje të kontratave. Kërkoj të sqarohet kjo çështje?

Sa i përket shqetësimit të dytë i cili ka të bëjë me qytetarët, por sot po e shprehu shqetësimin tim si anëtar i Kuvendit me një rast i cili ka ndodhur sa i përket një projekti i cili është realizuar në Lagjen e Zabelit. E falënderova për këtë rast komisionin mbikëqyrës, sepse nuk ka ra nën ndikimin e shefit të grupit të LDK-së Avdyl Aliu, sepse .z. Aliu para disa jave e ka ndërprerë projektin në mënyrë që të kalojë rrejtja e kanalizimit nëpër pronën komunale e cila pronë komunale gjendet në afërsi të pronës private të z. Avdylit. Ne kemi informacione se ky projekt është ndaluar nga shefi i grupit të LDK-së dhe tendenca është që të mos realizohet. Ky është shqetësimi im, sepse nëse një anëtar i Kuvendit bën pengesa në realizimin e projekteve të Komunës, atëherë kjo quhet padisiplinë dhe dhunë e cila ushtrohet nga zyrtarët e LDK-së.

Sa i përket informacioneve nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për Lumin Mirusha, unë e lexova informatën në pika të shkurta dhe e vërejtja se dinamika e punëve është theksuar se është tejkaluar, por dua ta di pse është një dinamikë aq e ulët e realizimit të projektit të kanalizimit, sepse për 6 muaj janë shtrirë 600 metra, kurse rregullimi i shtratit të lumit është ndërprerë plotësisht dhe nuk është punuar as një metër nga muaji dhjetor i vitit të kaluar. Pse është kjo pengesë dhe nuk po realizohet plani sipas dinamikës së paraparë? Në raportin e organit mbikëqyrës që iu është bashkëngjitur informatës së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, janë dhënë vlerësimet e organit mbikëqyrës dhe është konstatuar se kryetari i Komunës ka ndërhyrë në këtë projekt duke e rishikuar projektin të cilin ai vetë e ka miratuar derisa ka qenë kryetar i Komunës deri në vitin 2005.

Tash ky projekt ndryshohet me një kërkesë jo kompetente nga disa njerëz jo kompetent dhe nuk është e rrugës që ky projekt të ndryshohet në këtë masë.

Sa i përket informacionit se cilat janë 19 familje të cilave iu janë kompensuar dëmet materiale, por realisht nuk janë kompensuar fare! Gjithashtu shifra është e paqartë, janë 6 shifra. Nuk e di janë 13 mijë e 159 € apo 131 mijë e 957 €, prandaj kërkoj sqarim për këto shifra?

Avdyl Aliu- keni bërë mirë që keni dal në Zabel, por do të ishte më mirë të kishit dal pak më lartë te një pronë e shefit të grupit, por keni pasur një problem pak më të madh.

Unë së pari po flas për atë problem dhe kërkoj nga të gjithë kolegët këtu nga drejtorët

dhe do të kërkoj edhe personalisht nga kryetari që t' i bëjmë të gjithë një nder dhe t' i bëjmë një shërbim koleges sonë Shukrie Rapuca dhe tre-katër fqinjëve të saj në hapjen e një rruge e që quhet "Bajram Llovca". Kjo është një rrugë me një gjatësi e bllokuar afër 40 metra gjatësi. Më 24 të këtij muaji unë e kam vizituar këtë lagje dhe jam njoftuar më për së afërmi me këtë problem. Nga 5 palë zgjedhje të ndryshme që janë zhvilluar në Komunën tonë, zonja kolege së bashku me ish kryetarin, me Izmiun, Zenunin dhe të tjerët kanë qëndruar herë në odën e Agës Haxhi dhe herë në odën Agës Musë, duke i kërkuar votat e tyre në këmbim të hapjes së kësaj rruge. Disa prej tyre ia kanë dhënë votat, sepse duke qenë në zor, por rruga nuk është hapur kurrë!

Të mësuar nga kjo praktikë më kanë ftuar dhe mua dhe në njëfarë mënyre më kanë thënë hajde të goditemi si me ata të mëparshmit! Mirëpo unë i kam thënë pak më ndryshe, i kam thënë dal pas zgjedhjeve! Pas zgjedhjeve jam takuar me ata. Është interesant fakti se zonja kolege aty e ka të ndërtuar shtëpinë dhe sa kam unë informata shtëpia është edhe me leje ndërtimore, mirëpo nuk ka rrugë! Kjo është paradoks, interesant dhe e pakuptimtë si mund të ketë një shtëpi leje ndërtimore pa qasje në asnjë rrugë!? Ajo shtëpi nuk ka qasje në rrugë ! Dua t' ia bëj me dije zonjës kolege dhe fqinjëve të saj se të na del një zemër gjerë Isa Ymeri iu ka dhënë leje që të kalojë nëpër oborrin e tij derisa të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme për ata. Për gjashtë vite të qeverisjes së saj, zonja nuk mundi të bëjë zgjidhje për këtë problem të saj dhe fqinjëve të saj. Prandaj unë e thash në emër të saj dhe fqinjëve të sajë dhe kërkoj që të gjejmë një zgjidhje për këtë problem në mënyrë që mos të vijë deri te ndonjë incident ndoshta edhe me pasoja fatale. Thuhet se secili problem e ka një zgjidhje, prandaj edhe ky problem e ka një zgjidhje, por duhet ta kemi me hakikat për ta gjetur zgjidhjen e këtij problemi!

Gjithashtu dua t' i them edhe zonjës edhe dy kolegëve të sajë me çfarë morali kanë dal ata në pronën time ku është duke realizuar projekti i kanalizimit për ujërat atmosferike?

I keni mashtruar dy fqinjët e mi, Meten dhe Azemin, i keni mashtruar dhe jeni fotografuar tinëz me ata! Edhe i keni shqetësuar shumë ata duke postuar fotografi kinse për një informatë në një portal informativ. Ata kur kanë kuptuar se janë në portal informativ, menjëherë më janë paraqitur mua dhe menjëherë iu janë paraqitur edhe gazetarit, por nuk ka bërë askush një hap për ta demantuar atë, por ata janë shqetësuar shumë. Unë e përcolla shqetësimin e tyre. Nuk keni qenë të zot, nuk ke qenë e zonja ti dhe kolegët e tu t' i bëjnë udhë vetes dhe familjes së juaj t' i bëni udhë. Prandaj me çfarë të drejte del për ta drejtuar një kanalizim, kurse nuk i bën udhë shtëpisë sate!?

Sa për informatë ky kanalizim ta keni këtë informatë kalon nëpër tri prona të mia, kurse ju vetëm një e keni parë, por nuk e kam penguar. Ky kanalizim 191 metër gjatësi kalon nëpër tri pronat e mia dhe nuk kam penguar dhe nuk kam kërkuar kompensim, kjo të dihet! Unë jam sponzorues i këtij kanalizimi, prandaj si ka kuptim unë për ta penguar këtë? Trotuari nëpër të cilin ecin qytetarët e Zabelit në një pronë tjetër të shefit të grupit është pronë e imja, aty ka pasur muri, por e kam rrënuar murin dhe e kam ndërtuar murin e ri brenda dhe është hapur rruga. Nuk kam kërkuar kompensim as për tokën as për materialin e dëmtuar ! E kam thënë edhe më herët që kudo që të shkoni është mirë që ta lajmëroni dikë! Ka një zot shtëpie çdo kund, dikush iu pret dhe iu drejton. Duke qenë dera në Zabel, ju e keni kërcyer murin dhe dihet kush i kërcen muret dhe dihet mirë se kush hyn për dera dhe kush i kërcen muret! Nëse dikush ka moral duhet të kërkoj falje për një dezinformim të cilin ia ka bërë opinionit, sidomos ju që jeni këshilltarë komunal, por a kërkon apo nuk kërkon të mbetet në moralin e juaj!?

Shukrie Rapuca- së pari ky kolegu e përmendi emrin tim shumë shpesh vend e pa vend dhe pa hijshëm e që nuk ka qenë dashtë kështu, sepse unë e kam çmuar si koleg !

Aq shumë kam bashkëpunuar me te sa që në qeverisjen e mëparshme të partisë sime ka shkuar aq larg sa që më ka thënë zonja Rapuca ti mundesh për ta liruar vendin dhe të dal aty ku ka qenë ky! Kam qenë alete shumë e sinqertë me te dhe shumë drejtë kemi bashkëpunuar. E dyta ajo më e rënda që ishte, derën hapur e kemi të gjithë anëtarët e Kuvendit, me ligj e pa ligj, ne jemi të zgjedhurit e popullit dhe kudo kemi të drejtë të shkojmë të marrim pjesë dhe t' i japim mendimet dhe sugjerimet tona. Unë kam qenë e ftuar aty nga një bashkëvendës aty të cilit nuk po ia theksoj emrin. Bashkë me grupin kuvendar timin kam qenë dhe asgjë të keqe nuk kam bërë dhe nuk e kam shkel asnjë ligj. E treta pa vend ma përmende emrin! Si munde ashtu? Ke ardhur deri te oborri im dhe nuk më ke ftuar as mua, as atë emër që e përende ti, është e vërtetë tri herë i kam ftuar zgjedhjet dhe zgjedhjet i kam ftuar me punë dhe nderë 100%. Edhe pse asnjë punë nuk e kam kryer në lagjen time, sepse nuk kam mundur kurrë. Sa herë kam shkuar te votuesi i kam thënë ma jep votën kjo që jam dhe asgjë nuk të garantoj dhe premtoj. Vetëm një garanci mund ta jap, ligjin do ta respektoj 100%. Për drejtësi dhe sinqeritet do të punoj shumë, sepse jam fituese. Të gjithë e njohin Shukrie Rapucën si i ka ftuar votat, por e njohin edhe punën e familjes sime. Nuk jam nga ato që e kam gënjyer qytetarin! Me të gjitha këto punë që nuk i kam kryer e kam marrë votën dhe më është thënë në lagje, nëse kurrë nuk ndërtohet ajo rrugë ty do ta japim votën, sepse nuk kam kojshi më të mirë se ty, vetëm zoti që të ka sjell këtu!

Unë asnjëherë nuk kam thënë se mund ta ndërtoj atë rrugë, por kam thënë se do t' i ndjek procedurat ligjore. Ju e dini se si punon pushteti. Unë këtu e kam ngrit zërin si di vetë dhe nëpër labirinte nuk kam hyrë asnjëherë dhe nuk i shkeli rregullat kurrë për asnjë çmim, për asnjë rrugë dhe asnjë shtëpi dhe për asgjë tjetër! Sinqeritet, drejtësi, moral. Unë e di çka është politika, por megjithatë edhe në politikë ka moral. Kështu është kolegu im i nderuar dhe ajo e cila është më e rëndë dhe atë që e the, ajo është fyerje. “Goditeni sikur ata”, ata janë gjallë kur të doni i thërrasim në debat me qytetarë dhe patjetër duhet të mbajmë dhe aty e shohim kush goditet dhe kush nuk goditet?

Jam shumë e prekur dhe nuk ka pasur nevojë kështu emri im të përmendet, por besoj se diçka kam sqaruar.

Riad Rashiti-më vjen keq për sjelljet e shefit të grupit të LDK-së, sepse sa herë e merr fjalën thotë gjëra shumë të pavërteta. Ky gjithmonë ka bërë kërcënime në lagjen e vetë me njerëz të caktuar dhe bën fushatë kur nuk është kohë fushate!

Nuk është mirë një anëtar i Kuvendit, shefi i grupit të thotë të pavërteta këtu, sepse banorët e asaj lagjeje nuk kanë deshtë të përballen me shefin e grupit dhe ne kemi dal në vend të ngjarjes për ta parë problemin. Nuk e kemi ftuar askënd për të dal në fotografi, por ne kemi qëlluar aty dhe kemi biseduar me punë kryesin për ta zgjidhur problemin dhe jemi njoftuar me problemin të cilin e kanë ngrit ata banorë. Absolutisht nuk është e vërtetë këtë që e thotë z. Avdyli dhe duhet pyetur pse e ka penguar projektin e kanalizimit i cili kalon nëpër pronën komunale? Ky nuk e ka të drejtën as në pronë të vetë ta pengojë një projekt të rëndësishëm i cili është për Komunën e Gjilanit dhe qytetarët, por në asnjë mënyrë në pronën publike komunale.

Nevzad Isufi- apeloj që mos të personalizohen gjërat. Unë e kam një pyetje për kryetarin e cila pyetje ka të bëjë me ndërtimin e “Hip Petrolit” në anën e djathtë të rrugës Gjilan-Bujanoc, përball Restorant “Mili”. Pyetja e ime për kryetarin është; çka ka ndërmarrë për rrënimin e këtij objekti dhe sa është duke u përkrahur Inspeksioni Komunal, sepse në

fillim të ndërtimit ky objekt ka pasur mundësi të rrënohet me mjete të thjeshta dhe nuk ka pasur nevojë për tender për ta pritur eskavatorin, sepse kemi të bëjmë me një objekt përdhes dhe me një objekt me shumë kate.

Një pyetje tjetër ka të bëjë përkitazi me Rregulloren për organizmin dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale nr. 018355 dhe numër 970010 në kuadër të Administratës Komunale, funksionon njësi e veçantë Zyra për Integritet Evropian.

Kjo zyrë në mandatin e kaluar asnjëherë nuk ka dërguar material për shqyrtim në Kuvend.

Edhe për këtë periudhë 6 mujore, ky Kuvend nuk ka debatuar për kompetencat e kësaj zyre? Po ashtu edhe në debat për 100 ditët e kësaj qeverisje nuk është diskutuar fare dhe nuk është paraqitur ndonjë e dhënë për këtë zyrë.

Pyetja e ime është se cilat janë arsyet e mosfunksionimit të kësaj zyre dhe kur mund të shohim dhe vërtetojmë se kjo zyrë është në funksion dhe po punon?

Një pyetje është për DUMM, sepse para një kohe ka qenë në mjete të informimit se 16 objekte të larta ndërtimore nuk kanë bërë pagesën e lejeve ndërtimore, kurse Inspeksioni ka kërkuar që të bëhet kjo pagesë, sepse në të kundërtën do të bëhet rrënimi i tyre?

Mandej sipas mjeteve të informimit, drejtori Selver Xhelili ka pohuar se kjo shumë e ka vlerën 174 mijë €. Lidhur me këtë kam pyetje se transaksionet e lidhura të Komunës me pronarët e objekteve a janë të mbështetura në ligj dhe nëse po, me cilin ligj?

Pyetje tjetër kam për pronat e uzurpuara të cilave prona në legjislaturën e kaluar është bërë preson që të shpallen emrat edhe në portale dhe në mjete informative të Komunës. Konkretisht çfarë është bërë dhe çfarë masa janë marrë për uzurpim të pronave, trotuareve dhe hapësirave publike, a është ndërmarrë ndonjë masë ndaj këtyre uzurpuesve dhe si qëndron puna sot, a ka vazhduar uzurpimi apo kemi ndonjë parandalim?

Ibish Ibishi- këtu po zhvillohet një debat të cilin nuk dihet se si ta quajmë? A të themi debat i pleqnarëve, apo kuvend i të zgjedhurve? Nëse shkojmë aq larg siç po ndodh tash, më mirë është që këto çështje të debatohen nëpër oda të pleqve! Nëse dikush ka personale, atëherë pleqnarët le t' i zgjidhin këto çështje, kurse ky Kuvend e ka për obligim që të merret me problem me të cilat qytetarët ballafaqohen çdo ditë. Ne kemi aq shumë probleme sa nuk po dimë se nga t' ia fillojmë si janë probleme me rrugë, trotuar, kanalizim, ujësjellës, kurse dikush humb kohë dhe ne duhet të mbesin peng i dy-tre personave të cilët kanë çështje personale për pronat e tyre. Nuk është mirë të vazhdohet me këso debate në Kuvend, por të bëjmë punë konkrete të cilat i duhen qytetarëve.

Më mirë do të ishte të dalim jashtë qytetit dhe në fshatra dhe të shohim si jetojnë ata njerëz? Në të ardhmen drejtorët duhet të dalin nëpër fshatra t' identifikojnë uzurpatorët, kush po e ndot ambientin, kush i ka ngushtuar rrugët e fshatrave etj. Ne jemi të obliguar t' i paraqesim të gjitha problemet në këtë Kuvend, sa që njerëzit nuk mund të rrinë të qetë në shtëpi nga zhurmat e ndryshme, kurse ne këtu debatojmë për çështje që nuk qojnë peshë fare! Të merremi me punë më konkrete dhe t' i lëmë inatet personale!

Nazmi Musa- të nderuar tash po bëhen gjashtë orë që ne drejtorët jemi këtu të ulur! Kërkoj respekt për punën që e kemi dhe për detyrat që na presin. Gjashtë orë biseduam për të dhënë një përgjigje eventuale. Kjo përgjigje përsëri nuk është e plotë karshi asaj çka kërkohet? Tani posa të përfundojë kjo mbledhje, ju shkoni në punë të juaja dhe deri pas një muaji nuk do të keni të tjera punë. Ne për çdo ditë kemi punë, vetëm nesër p.sh e kam, stresin e testimit, sepse 3600 nxënës kanë për të hyrë në test, kurse ju merreni me çështje krejtësisht private! Lironani neve të shkojmë, kurse pyetjet bëni me shkrim dhe ne iu kthejmë përgjigjet. Gjashtë orë biseduam këtu dhe tani thoni dërgoni pyetjet me

shkrim. Çka është kjo punë kështu?

Avdyl Aliu- ne nuk po bisedojmë për çështje private. Më parë kuvendarëve i kanë thënë pleqnar, prandaj edhe ne pleqnar jemi. Hapja e rrugës nuk është çështje private, por është shkelje, sepse e keni dezinformuar opinionin se gjëja unë kam bërë pengesë! Qëllimi është i mirë dhe nuk e kam të qartë pse po shqetësohet kolegia. Qëllimi është i mirë për ta hap një rrugë për atë zonjë dhe të tjerët.

Bajram Hasani- unë e lus drejtorin e arsimit për qetësi, sepse nuk është ai që e cakton agjendën këtu dhe nuk mund të ushtrojë diktat, sepse detyrën askush nuk ia ka dhënë me dhunë! Kërkojmë që të na dëgjon edhe neve, sepse edhe ne kemi të gjithë punë, por kemi ardhur sot t'i debatojmë këto pika të rendit të punës të cilat janë paraparë. Mos të bëhen aso dirigjime me këshilltarët komunal!

Nazmi Musa- për hir të kulturës dhe respektit ndaj jush mund të kërkoj falje për tonin me të cilin iu drejtova, por arsyetimet janë përtej asaj që e thash. Unë nuk jam këtu për herë të parë këtu në Kuvend dhe e di si funksionon Kuvendi. Unë jam këtu për t' u përgjigjur në pyetjet e juaja dhe për të dëgjuar se cila rrugë do të ndërtohet dhe cila shtëpi do të rrënohet dhe cili kanalizim do të rregullohet! Unë i përgjigjem pyetjeve të cila ti bëni ju për arsim dhe vetëm për arsim unë flas. Këshillat janë të një natyre tjetër dhe jo të kësaj që po e them.

Unë i pari kam kërkuar që të mbahet një seancë vetëm për çështje të arsimit, por përderisa ju keni obligime ndaj atyre që ia keni marrë votat duke i mashtruar se do ta bëj këtë e atë, kurse tash nuk mund t' i realizoni ato premtime, sepse po e shihni se nuk mund t' i realizoni, neve na humbni kohë 6 orë këtu.

Kanë kaluar gjashtë muaj dhe asnjëherë dhe as pesë minuta nuk keni kërkuar kohë që të debatonim për çështje të arsimit. Unë mendoj se neve na ndan një rrugë prej një rruge tjetër, unë mendoj se arsimi na bashkon të gjithëve dhe të gjithë duhet ta kemi vëmendjen për çështjen dhe cilësinë e arsimit. Unë edhe më parë e kam thënë se çështja e arsimit nuk mund të debatohet vetëm me një pyetje nën të ndryshme, por është temë që në çdo seancë do të duhej të debatohet.

Kriteret për ndarjen e normave për të cilin rast u bë fjalë! Normat bëhen në bazë të vendimeve të cilat ju dhe ata që bëjnë pyetje, të cilët bëjnë pyetje, por nuk i lexojnë ligjet. Ju lus lejoni ju që unë t' i shkeli udhëzimet administrative të ministrisë? Ju lus gjeni parat unë vazhdoj punën, nuk do të paraqitet problem!

Valentina Bunjkau-Rexhepi- arsimi është një problematikë e gjerë, prandaj unë propozoj që më 15 korrik në ora 10 të mbahet një seancë në të cilën si temë debati do ta kemi vetëm çështjen e arsimit.

Leonorë Bunjku- unë mendoj se dy javë janë shumë dhe mund të bëhet vonë, sepse ndarja e orëve ka filluar, mësimdhënësit janë në konfuzitet, prandaj sa më parë duhet debatuar për çështje të arsimit.

Valentina Bunjkau-Rexhepi-kush është për që këtë të martë, më 1.7.2014 në ora 10 të mbahet një seancë vetëm për çështje të arsimit?

Aprovohet propizmi i kryesueses që të martën më 1.7.2014 në ora 10 të mbahet një seancë e jashtëzakonshme vetëm për çështje të arsimit.

Sahit Abazi – unë e falënderoj drejtorin e Arsimit, por e kam një replikë me përfaqësuesin e “Vatrës” i cili e pati një keqkuptim. Unë nuk jam kundër atyre që janë punësuar, por problemi është se për secilin vend të punës kanë konkurruar nga 23 kandidatë dhe nëse dihet paraprakisht se kush do të punësohet, atëherë shtrohet pyetja pse ne shpallim konkurse dhe i maltretojmë nga 23 njerëz për një vend të punës!? Këtë kam deshtë ta them dhe besoj se keni mirëkuptim për atë që e thash. Për mua nuk janë me rëndësi interesat partiake, por për mua është me rëndësi që të vijmë në konsideratë njerëzit sa më profesional dhe më të mirë.

Isa Agushi- unë më tepër flas për fshatin tim Zhegrën dhe për drejtorin e Shërbimeve Publike e kam një pyetje: çdo ditë banorët e Zhegrës pyesin se kur do të bëhet rregullimi i trotuarit në Zhegër? Është një trotuar i cili duhet të bëhet urgjent, sepse aty kalojnë me mijëra nxënës dhe banorë të tjerë çdo ditë ka rreziqe nga makinat. Duhet zgjidhur këtë çështje sa më parë, sepse nesër mund të bëhet vonë.

Nevzad Rushiti- unë e kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, por edhe një sqarim për kuvendarët dhe opinion se në Dhe të bardhë, 13 rrugë janë në procedurë të renovimit me të cilin rast i falënderojmë të gjithë anëtarët e Kuvendit të asaj lagjeje dhe drejtorin e Shërbimeve Publike. Gjithashtu duhet ta përkrahim edhe kryetarin e Komunës, sepse shumë projekte kanë filluar dhe janë në përfundim e sipër.

Në anën tjetër është një kërkesë e qytetarëve të kësaj lagjeje, sepse një pjesë e rrugës qarkore është në gjendje shumë të rëndë për shkak të ujërave të zezave dhe kanalizimeve të cilat qarkullojnë mbi sipërfaqe. Drejtori është i njoftuar me këtë gjendje, prandaj edhe e ka marrë për obligim për ta sanuar këtë rrugë.

Gjithashtu edhe te Muhaxhirët e Shillovës është një shqetësim, sepse kjo lagjeje (fshat) nuk kanë kanalizim për ujërat e zeza, prandaj është mirë që të bëhet lidhja e atij kanalizimi me “Hip Petrolin” në mënyrë që mos të kundërmojë kjo lagje në këtë kohë kur po mbajnë temperaturat e larta.

Jehonë Hyseni- edhe unë e përkrahi propozimin e z. Agushi për rregullimin e trotuarit në fshatin Zhegër i cili trotuar është një nder problemet më të mëdha të këtij fshati.

Mirëpo e kam edhe një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike ose të Urbanizmit, pse janë ndërpre punimet në rrugën e cila lidh Lladovën dhe Nasalen dhe kur pritet të fillojnë punimet?

Ne jemi të informuar se dezinfektimi në disa lagje të qytetit ka filluar ndoshta duku edhe ka përfunduar, por a do të ndodh ky dezinfektim edhe në fshatra?

Zijadin Maliqi- unë kam pak fjalë rreth ecurisë së punës së Kuvendit. Në fillim u propozua rendi i punës dhe u bë një numër i madh i pyetjeve dhe u dhanë përgjigje.

E dha sqarimin kryetari e që duhet të parashihet me statut dhe të gjithë jemi të interesuar që të ndodh ajo, por me statut duhet të precizohet koha sa do të zgjat kjo procedurë.

Nën të ndryshme, çështjet të cilat duhet të shtrohen duhet të caktohen në fillim dhe duhet përcaktuar se për cilën çështje ka interesim? Ne duhet ta dimë se çka ka nën të ndryshme, mirëpo pas dy orëve përsëri na u krijua situata e parë dhe asgjë tjetër!

Duhet ndal këtë praktikë, të punohet si duhet dhe mos të krijohet një gjendje konfuze.

Selver Xhelili- unë i pata disa pyetje na anëtarët e Kuvendit dhe njëra ndër ato ishte për rrënimin të cilin e kemi bërë dje. Është e vërtetë se Komuna nuk ka kompani për rrënim,

por duke parë se ai objekt ka paraqitur rrezik, unë e kam obliguar pronarin e atij objekti që vetë ta bëjë rrënimin, kurse Komuna nuk e ka asnjë obligim për këtë rast.

Pyetja e dytë ishte lidhur me Fabrikën “Consoni” dhe është vërtetë se është një shqetësim në këtë lagje, por ky shqetësim është adresuar në organet kompetente e që është Ministria e Ambientit. Unë i kam ftuar përfaqësuesit e kësaj ministrie të cilët e kanë vizituar këtë fabrikë dhe besoj se kjo ministri do të marrë masa dhe do të vijë me një vendim përfundimtar. Çështja e mbeturinave në atë rrugë e të cilat janë një kohë të gjatë, por ne kemi pasur biseda me Ecohigjienën dhe do të marrim masa konkrete për t’i eliminuar ato mbeturina e të cilat qëndrojnë me vite aty.

Pyetje tjetër ishte për Hip Petrofit, por sipas informatave që i kam, ky objekt është pajisur me shumicën e pëlqimeve nga Ministria e Ambientit dhe është duke e pritur pëlqimin për t’u inkuadruar në rrugën regjionale. Me marrjen atij pëlqimi, atëherë DUMM do ta merr vendimin përfundimtar për lejen e ndërtimit.

Puna e pagesës së lejes së ndërtimit ku drejtorja e Inspeksionit ka thënë se janë 170 mijë € obligime nga 6 objekte të larta është e vërtetë se ne në bashkëpunim me DUMM kemi biseduar me këta pronarë dhe kemi arrit që t’i inkasojmë ato borxhe. Këto ishin përgjigjet e mia të cilave pyetje u mundova t’i përgjigjem qartë dhe shkurtë.

Sokol Haziri- unë po filloj nga pyetja e Bujar Nevzadit i cili ka bërë pyetje për ndriçimin në qendër të qytetit të cilat nuk funksionojnë (vetëm krahu i djathtë) funksionon. Mirëpo ka qenë një aksident komunikacioni i cili e ka dëmtuar një shtyllë, por për mos të bërë laramani dhe për të qenë shtyllat të njëjta është bërë një vonesë, kurse tash punimet janë duke u kryer dhe së shpejti do të funksionalizohet ndriçimi.

Mandej Fehmi Sylejmani ka pyetur për pusetat problematike nëpër rrugë për shkak të cilave gati sa nuk ndodhi një fatkeqësi. Mirëpo deri te kjo ka ardhur, sepse punë kryesi nuk i ka vendosur në mënyrën e duhur. Ne këto i kemi riparuar dhe do të përpiqemi t’i riparojmë, por është një dukuri e shëmtuar, sepse po ndodhin vjedhje nga ana e keqpërdoruesve!

Rruga e IX “Dardania I” asfaltimi- Disa pjesë të rrugëve nuk kanë mundur të kryhen me mirëmbajtje verore, prandaj kemi vendosur ta shtrijmë nga një shtresë. Nuk ka përfunduar procesi i mirëmbajtjes verore dhe ato që janë planifikuar sipas radhës do të kryhen. Rruga te Deponia, për të cilin rast ka pasur vërejtje nga opozita dhe gjendja është ashtu. Mirëpo ne e kemi dorëzuar në Zyrën e Prokurimit kërkesën për tenderim të kësaj çështje dhe presim që t’i zotojmë mjetet dhe ta eliminojmë këtë shëmti. Gjithashtu edhe rruga në fshatin Miresh deri te Lumi Morava do të jetë e pastruar.

Për trotuarin në Zhegër, jam i bindur se nuk ka kosto financiare të larë ky trotuar dhe besoj se dot ë jetë një nga prioritetet e Zyrës së Prokurimit.

U bë pyetje për Shillovën, ndoshta në këtë fillim të mandatit do të jetë më e vështirë për t’i realizuar të gjitha projektet, por në vazhdim të mandatit, besoj se edhe problemi i këtij fshati do të zgjidhet.

Sa i përket pyetjes së Jehonës për rrugën LLadovë-Nasalë, nuk është në kompetencë time të përgjigjen, sepse për këtë duhet dhënë përgjigje Zyra e Projekteve dhe ajo e Kryetarit dhe DUMM. Unë e di sa ka probleme me dheun i cili është i butë dhe shtresën e butë e të cilat pasoja duhet eliminuar. Ju falënderoj shumë, shkurtimisht këto ishin përgjigjet e mia.

Fehmi Sylejmani- drejtori i Shërbime Publike u përgjigj, por në pyetjen tjetër ndoshta duhet të përgjigjet drejtori për Zhvillim Ekonomik. Dy rrugë në Dardani, rruga e II dhe XII, janë rinovuar, kurse në rruga e VII nuk kanë filluar punimet, prandaj unë kam

pyetje pse në këtë rrugë nuk kanë filluar punimet?

Sahit Abazi- unë e kam një paqartësi përkitazi me përgjigjen për ndriçim në qendër të qytetit. Kryetari e tha se këtë e kemi bërë për të kursyer energji, kurse drejtori e tha se ka qenë një aksident komunikacioni! Të dytë mbiemrin haziri, por nuk e dimë cilit t' i besojmë.

Ismail Jonuzi- u bë pyetje për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet. Vlera e dëmeve është 13 mijë 597 €.

Sa i përket vonesë së projektit të Lumit Mirusha, ky projekt është kontraktuar në vitin 2012 dhe plani dinamik e ka kaluar afatin për 410 ditë. Mirëpo në këtë projekt dhe këtë kompani e kemi gjetur dhe mendoj se kanë filluar punët jo sipas dinamikës së paraparë, por mendoj se tash është një ecuri dhe përshpejtim më efikas.

Sa i përket rrugëve ne e kemi ngrit një komision për të parë mundësitë e ndërmarrjeve, sepse në një anë janë të interesuara që të marrin punë sa më shumë, kurse në anën tjetër nuk kanë kapacitete për t' i kryer punët. Ne jemi duke punuar në këtë drejtim dhe besojmë se së shpejti do të normalizohet gjendja edhe te kompanitë me vetë faktin se kemi filluar që t' i servisojmë borxhet edhe te kompanitë.

Me këto debate dhe vendime, seanca e VIII (tetë) i përfundoi punimet në ora 16.30 min

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit

Sali HASANI

Valentinë Bunjku- Rexhepi